

Kumbona e së Diellës



Kuvendi i tretë i Arbnit - Shkodër 1895

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.5/6, Maj - Qershor 2015

FESTA E KORPIT DHE GJAKUT TË KRISHTIT NË QYTETIN E SHKODRËS

Shkodër, 4 Qershor 2015.

Dita 4 qershor e këtij viti zgjoi në këmbë qindra besimtar, duke dalë në rrugët e qytetit të Shkodrës për ta kremtuar festën e Korpit dhe Gjakut të Krishtit. Procesioni me të Shenjtërueshmin Sakrament, i nisur nga Katedrala e Shkodrës, udhëhequr nga Imzot Angelo Massafra dhe meshtarët e shumët, kaloi neper rrugën e Gjuhadolit për të përfunduar të Kisha e Shën Françeskut në Gjuhadol.

Zanafilla e kësaj Feste

Festa e Korpit dhe Gjakut të Shenjtnueshëm të Krishtit, e cila në Meshar të mëpashëm njëhej me emrin latinisht "Corpus Domini", filloi të kremtohej që më 1264, në kohën kur ishin shtuar përshtypjet ndaj eukaristisë, për t'iu kundërvënë doktrinave heretike rreth pranisë së Krishtit në hosten e shuguruar. Kjo festë u shtri në Kishën mbarë nga Papa Urbani IV, (1261-1264). Qe pikërisht ky papë i cili e kremtoi personalisht festën e parë të Korpit të Krishtit në Orvieto (Itali), në verën e të njëjtit vit, me solemnitet të madh. Në Romë kremtimi filloi që në kohën e papës Nikolla V, (1328-1330) me Meshën në Bazilikën e Shën Gjjonit në Lateran dhe procesionin drejt Bazilikës së Shën Marisë së Madhe.

Historiku në Shkodër

Procesionet në qytetin e Shkodrës, datojnë që në vitin 1896. Procesionet organizoheshin për festa të ndryshme, si Festa e Shën Shtjefnit, Shën Lorencit, Zoja Magdalën e tj. Procesioni më i organizuar dhe



më i vjetri ishte i Zojës së Këshillit të Mirë, ku populli nga Kisha Katedrale shkonin deri të Kisha e Zojës bri kalas Rozafat.. Ndër festa të tjera, spikaste procesioni i Ditës së Korpit dhe Gjakut të

Krishtit, i cili shoqërohej, nga vajzat e motrave Stigmatine veshur me kostume kombëtare, Kompanit fetare të ndryshëm, nxënësit e shkollave më flamujt e tyre, etj.. Në procesione që zhvilloheshin neper rrugët e qytetit, merrnin pjesë deri në vitin 1918 edhe diplomatet e huaj të akredituar në Shkodër. Procesionet të zhvilluar jashtë oborrit të Katedrales kanë vazhduar deri në vitin 1947. Kurse, procesioni i fundit i zhvilluar përbrenda oborrit të Katedrales ishte në vitin 1954, për tu rikthyer përsëri pas diktaturës, gjatë viteve të demokracisë.





Papa Françesku PAQJA NUK SHPALLET, JETOHET	4
Georg Frendo FIGURA E MESHTARIT	7
Don Lush Gjergji OSCAR ROMERO	10
Don Nosh Gjolaj MIRËNJOHJA E TË DREJTËS MARTESORE	12
Don Pren Kola FJALORI LITURGJIK	15
Dr. Kastriot MARKU KONÇILI I TRETË SHQIPTAR	17
Ledi Shamku-Shkreli SHTJEFËN GJEÇOVI THEMELUES I ETNOGRAFIË	20
Iliriana Koleka KONGRESI I MANASTIRIT	24
Tonin Çobani PESË MUNDIMET E FISHTËS	26
Anton Nikë Berisha PJETËR BUDI DHE TRADITA LETRARE	29
Dom Nosh Gjolaj SHËN ROZA NGA LIMA VIRGJËR	31
VITRINA E LIBRIT	32

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXIX, nr. 5/6 (476-477) Maj - Qershor 2015

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Artur Jaku
Loreta Tomaj

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
nike.ukgjini@gmail.com
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

PAPA FRANÇESKU NË SARAJEVË:

**“PAQJA NUK SHPALLET, JETOHET”,
THIRRJE POLITIKANËVE TË PUNOJNË PËR ZHVILLIMIN E VËRTETË**

Sarajevë, 6 Qershor 2015.

“Kurrë më luftë!”. Kjo është thirrja e Papa Françeskut gjatë meshës së shenjtë të mbajtur në stadiumin Olimpik në Kosevo të Sarajevës në Bosnje. “Kam ardhur si pelegrin i paqes dhe i dialogut” sapo vuri këmbë në Sarajevë, qytet që dikur i kujtonte konfliktet e një kohe por që tashmë e sheh si një vend bashkëjetese.

Pas një udhëtimi të shkurtër, Papa, me 6 qershor, 2015, arriti në Sarajevë, i shoqëruar nga 65 gazetarë, kameramanë, fotografë e përfaqësues të tjerë të medias nga dhjetë vende të ndryshme, që po e informojnë botën për këtë shtegtim në 8-9 gjuhë. Të tjerë e prisnin në Sarajevë. Në këtë udhëtim të shkurtër, e shkurtër ishte edhe përshëndetja e Papës drejtuar grupit të gazetarëve: “Mirëdita e ju falënderoj për praninë tuaj”, fjalët, dashamirë si gjithnjë, të Françeskut. Sarajevën e quajnë Jeruzalemi i



Perëndimit: është qytet me kultura fetare dhe etnike krejt të ndryshme; e jo më pak, qytet që vuajti shumë në histori e tani ecën në udhën e bukur të paqes. Që të flas për këtë, po e bëj shtegtimin: si shenjë e paqes e si lutje për paqen. Ju falënderoj për shoqërinë tuaj”.

Veprimtaria e parë e Papës në Sarajevë, takimi i mirëseardhjes në pallatin presidencial, me tre anëtarët e presidencës si dhe me autoritetet e vendit. Përshëndetjen e mirëseardhjes e nisi me kujtimin e vizitës historike të Gjon Palit II, më 1997, në Sarajevë, më pak se dy vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Paqes në Dayton, përshëndetja e parë e Papës drejtuar Qytetit Martir e banorëve të tij si dhe mbarë Bosnjë-Hercegovinës. Që asokohe, nënvizoi, janë bërë përparime të ndjeshme, por duhen bërë edhe hapa të tjera, për ta fuqizuar besimin e për të krijuar raste që ndihmojnë në thellimin e njohjes e të nderimit reciprok. Për ta favorizuar këtë udhë, është themelore afërsia dhe bashkëpunimi i ngushtë i Bashkësisë Ndërkombëtare, posaçërisht i Bashkimit Evropian si dhe të gjitha vendeve e organizatave të pranishme në këto troje: “Bosnjë-Hercegovina, theksoi me forcë Papa, është pjesë përbërëse e Evropës; sukseset e

dramat e saj, janë pjesë përbërëse e historisë së dramave evropiane, e njëkohësisht, edhe qortim serioz, i cili na kujton se duhet bërë çdo përpjekje e mundshme që proceset e paqes të fuqizohen e të mos ketë kurrë më kthim mbrapa”.

Paqja e harmonia ndërmjet Kroatëve, Serbëve e Boshnjakëve si dhe marrëdhëniet e përzemërta e vëllazërore ndërmjet myslimanëve, hebrenjve e të krishterëve, duhet të dëshmojnë para mbarë botës se bashkëpunimi ndërmjet etnive e feve për të mirën e përbashkët është plotësisht i mundshëm, ashtu si pluralizmi i kulturave e i traditave, që mund të frymëzojë e të shërbejë në gjetjen e rrugëzgjdhjeve origjinale e të frytshme për problemet. Kështu edhe plagët më të thella do të mund të shërohen përmes një udhe, që paston kujtesën e jep shpresë për të ardhmen.

Papa Françesku nënvizoi me forcë sa rëndësi ka kjo udhë, në kontekstin e mizorive të atyre, që do të dëshironin ta përdornin çdo larmi, si pretekst për dhunë gjithnjë më të egër: “Është urgjente të njihen vlerat themelore të humanitetit të përbashkët; ato vlera, në emër të të cilave mund të bashkëpunojmë, të

ndërtojmë, të dialogojmë, të falim e të rritemi, në vend që të përhapim urrejtjen”. Politikanët kanë detyrën dhe përgjegjësinë të sigurojnë të drejtat themelore të njeriut, ndërmjet të cilave, liria fetare, për të ndërtuar kështu, një shoqëri paqësore e të drejtë: “E që kjo të realizohet, është e domosdoshme barazia e njëmendtë ndërmjet të gjithë qytetarëve përballë ligjit si dhe zbatimi i saj konkret në jetë, pavarësisht nga përkatësia etnike, fetare e gjeografike. Kështu të gjithë, pa dallime, të ndjehen plotësisht pjesëmarrës në jetën publike e, duke gëzuar të njëjtat të drejta, të mund të japin kontributin e tyre të posaçëm në shërbim të së mirës së përbashkët”. Së fundi, Papa nuk mund të mos kujtonte kontributin e Kishës Katolike në veprimtarinë rindërtuese, materiale e morale, të Bosnjë-Hercegovinës si dhe nxitjet e Selisë së Shenjtë për të promovuar paqen e dëgjimin reciprok, në kushtet e një bashkëjetese civile e të rregullt, kushte të domosdoshme për zhvillimin e vërtetë e të qëndrueshëm.

Mesha në stadiumin e Koshevos: “Paqja nuk shpallet, jetohet”/

Ndoshta, takimi më i rëndësishëm i ditës, së bashku me përqaftimin e të rinjve, ishte mesha e Papës Françesku në stadiumin e Koshevos, i rrethuar nga varrezat e improvizuara të viktimave të luftës së Bosnjës, që gjatë rrethimit të gjatë të Sarajevës, nuk kishin as varr për mort. Të mbijetuarit i futën nën dhe të vdekurit e tyre si mundën e ku mundën. Foli për paqen, Ati i Shenjtë, duke vënë ballë për ballë leximet biblike me gjendjen e sotme. Foli për drejtësinë, e cila sjell paqen, siç thotë Isaia profet. Paqja është një nga lumnitë e Ungjillit, theksoi para 65 mijë besimtarëve, që e kishin mbushur si kurrë ndonjëherë stadiumin, rrugët e sheshet, pranë tij. Me patos, Ati i Shenjtë, që në fillim të homelisë, u tërhoqi vëmendjen boshnjakëve shumëetnikë e shumëfetarë, se: “Paqja është ëndrra e Zotit, është plani i Hyjit për njerëzimin, për historinë, së bashku me gjithë krijesat. Është plan, që kundërshtohet gjithnjë nga njeriu e nga i Keqi. Edhe në kohën tonë, aspirata për paqen dhe impenjimi për ta arritur ndeshen me faktin se në botë ka konflikte të shumta të armatosura. Është një lloj lufte e tretë botërore, që zhvillohet “pjesë-pjesë”; e, në kontekstin e komunikimit global, perceptohet si atmosferë beteje”. “Kurrë më luftë”, përsëriti Papa Françesku fjalët e shën Gjon Palit II, i cili në vitin 1994 nuk mundi ta vizitojë Bosnjë-Hercegovinën për shkak të çekinëve – gati të shtinin mbi këdo, edhe mbi Atin e Shenjtë, i cili, gjithsesi, pati frikë jo për vete, por për besimtarët. Arriti të shkojë më pas në Sarajevë, në vitin 1997. E Papa Françesku ngriti zërin kundër

atyre, që duan ta ushqejnë luftën me qëllim, për interesa të ulëta; kundër atyre, që krijojnë ndeshje ndërmjet kulturave e qytetërimeve, që spekulojnë me shitjen e armëve: “Por luftë do të thotë fëmijë, gra e të moshuar në kampet e refugjatëve; do të thotë shpërngulje me zor; do të thotë shtëpi, rrugë, fabrika të shkatërruara; do të thotë sidomos, sa e sa jetë të përgjysmuara. Ju e dini mirë, e keni provuar pikërisht këtu: sa vuajtje, sa shkatërrim, sa dhimbje!”. “Paqja është rrjedhojë e drejtësisë. Edhe këtu: jo një drejtësi e deklamuar, e teorizuar, e planifikuar... por një drejtësi e praktikuar, e jetuar. E Besëlidhja e Re na mëson se drejtësia më e plotë është të duash të afërmin si vetveten. Kur, me hirin e Tënzot, e ndjekim këtë urdhëresë, ah si ndryshojnë gjërat! Sepse ndryshojmë ne!”. Shën Pali Apostull, vijoi Papa, në Leximin e dytë të meshës, na tregon cilat janë sjelljet e nevojshme për arritjen e paqes: dhembshuria, mirësia, përvujtnia, ëmbëlsia, zemërgjerësia, falja e durimi. Me këto sjellje, tha Ati i Shenjtë, bëhemi artizanë të paqes: “Por, të mos kujtojmë se kjo varet vetëm prej nesh! Do të binim në një moralizëm zhgënjyes. Paqja është dhuratë e Zotit, jo në kuptimin magjik, por sepse Ai, me Shpirtin e Tij, mund t'i dikojë këto qëndrime në zemrat tona e në korpin tonë, duke na kthyer në mjete të vërteta të paqes së Tij. E, nëse shkojmë më thellë, Apostulli thotë se paqja është dhuratë e Zotit, sepse është fryt i pajtimit të Tij me ne. Vetëm nëse pajtohet me Zotin, njeriu mund të bëhet veprimtar i paqes”. Kurrë më shumë se në këtë çast, nuk mori kuptim motoja e udhëtimit të Papës Françesku në Sarajevë: “Mir vama” (Paqja qoftë me ju), të cilën Ati i Shenjtë e shqiptoi disa herë në gjuhën vendase.

Ati i Shenjtë, në takimin ekumenik e ndërftar: së bashku, për ardhmërinë e paqes e të vëllazërimit/

Pas takimit të parë me njerëzit e Kishës, Papa mori pjesë në takimin ekumenik e ndërftar, në qendrën ndërkombëtare studentore françeskane. Për ta pritur Françeskun, që shoqërohej nga kardinali Puljiç, kishin dalë provinciali i fetërve dhe krerët e bashkësive myslimane, ortodokse katolike e hebraike të Bosnjë-Hercegovinës. Të pranishëm në takimin, që lidhej ngushtë me angazhimin e Këshillit vendas për Dialogun Ndërfetar të përbërë nga myslimanë, të krishterë e hebrenj, të gjithë përfaqësuesit e konfesioneve fetare të Bosnjë-Hercegovinës. Ky Këshill koordinon nismat e përbashkëta dhe ballafaqimin me autoritetet shtetërore. E këtë kujtoi edhe Papa që në fillim të takimit, duke e vlerësuar lart veprimtarinë e tij e duke e quajtur pasuri e vërtetë, në shërbim të zhvillimit shoqëror, kulturor e shpirtëror të

këtij rajoni, udhëkryq ndërmjet popujve e kulturave, që e ka provuar tepër shpesh shijen e hidhur të përçarjeve e luftërave gjakatare. Papa Françesku kujtoi edhe se lindja e Këshillit për Dialogun Ndërfetar dhe nismat e tjera në fushën ekumenike dhe ndërfetare filluan nga fundi i luftës, si përgjigje ndaj kërkesës për pajtim dhe ndaj nevojave të ngutshme për rindërtimin shoqërisë, edhe ajo e rrënuar nga konflikti: “Dialogu ndërfetar nuk kufizohet në diskutimin për temat e fesë. Dialog do të thotë të ndash me të tjerët të përditshmen e jetës. Kështu njeriu mund të projektojë një ardhmëri më të mirë, mund të mësojë t’i pranojë ndryshimet e të ndërtojë një shoqëri të themeluar mbi tolerancën dhe respektin reciprok”.

Ka shumë rëndësi që dialogu ndërfetar të mos kufizohet vetëm në veprimtarinë e drejtuesve të bashkësive fetare, por të shtrihet në jetën e të gjithë besimtarëve, tha Papa, posaçërisht të të rinjve, duke përfshirë sfera të ndryshme të shoqërisë civile: “Dialogu, për të qenë i vërtetë dhe i frytshëm, hamendëson një identitet të formuar, duhet të shprehë identitetin e të gjithë anëtarëve, përndryshe bëhet i kotë e i dëmshëm”.

Së fundi Papa u rikthye tek figura e Sarajevës: “Nga njëra anë, nënvizoi, ajo është simbol i luftës e i shkatërrimit, por nga ana tjetër, qyteti është edhe simbol i përpjekjeve të bëra nga popuj, kultura e fe të ndryshme për të qenë shenjë e unitetit; mesazh, ky, për botën e copëtuar nga konfliktet, që flet e thotë se mund të jetohej në mes të larmive, duke pasur parasysh se shoqëria përbëhet nga njerëzit, e njerëzit mund e duhet ta ndërtojnë së bashku ardhmërinë e paqes e të vëllazërisë”.

Tri dëshmi dramatike në takimin e Papës me klerin, në Sarajevë/

Një murgeshë nga Travnik, rrëmbyer, abuzuar e rrahur nga milicët islamikë arabë, që morën pjesë në luftën e Ballkanit; një meshtar i sekuestruar në Knin të Kroacisë nga ushtarë, që e torturuan derisa i ra të fikët; një frat françeskan i Posavinës, i internuar nga policët serbë në një kamp përqendrimi, rrahur e kërcënuar se do ta rrjepnin të gjallë, pastaj i ndihmuar nga një grua myslimane, para se të lirohej pas katër muajsh, të cilat iu dukën pa fund. Këto ishin dëshmitë dramatike, që dëgjoi Papa Françesku në takimin e parë të pasdites, me meshtarët, rregulltarët e seminaristët në katedralen e Sarajevës. Tri dëshmi të gjalla të luftës në Bosnjë-Hercegovinë (1992-1995), që e bënë Atin e Shenjtë të përkulej para meshtarit e t’i puthte duart duke i kërkuar bekimin, si edhe të përqafonte fort fratin e murgeshën. Papa e la mënjandë fjalën e përgatitur e foli pa letër: “Dëshmitë flasin vetë. Kjo

është kujtesa e popullit tuaj. E një popull, që harron, nuk ka të ardhme. Kjo është kujtesa e etërve dhe e nënave tuaja në fe: folën vetëm tre, por pas tyre, ka shumë burra e gra, që kanë vuajtur njëlloj... Nuk keni të drejtë ta harroni historinë tuaj. Jo për t’u hakmarrë, por për të arritur paqen. Jo për ta parë si diçka të çuditshme, por për të dashur, siç deshën këta. Në gjakun tuaj, në thirrjen tuaj, është thirrja, është gjaku i këtyre tre martirëve. E është gjaku e vokacioni i sa e sa murgeshave, sa e sa meshtarëve, sa e sa seminaristëve”. Këta ju kanë transmetuar fenë, vijoi Papa, i cili vuri në dukje se fjala, që u përsërit më shumë gjatë dëshmive ishte “falje”. Nuk është e lehtë të falësh atë, që të torturon, të rreh, të shkel, të kërcënon, të lë për 120 ditë në kampin e përqëndrimit, siç i ndodhi fratis françeskan. E ky numër – element tjetër, që i mbeti në mend Atit të Shenjtë – nuk është thjesht numër ditësh, por minutash e sekondash, sepse janë minuta e sekonda torture, orë, në të cilat të gjithë të internuarit jetojnë së bashku të palarë, të pangrënë, pa ujë, në të ftohtë e në të nxehtë, për shumë e shumë kohë: “E ne, që ankohe mi kur na dhemb ndonjë dhemb, që duam televizionin në dhomën e rehatshme, që bëjmë thashetheme për eproren ose eporin, kur nuk na pëlqen gjella... Murgesha, meshtarë, ipeshkvij, seminaristë me mendësinë e kësaj bote... janë karikaturë: nuk duhen gjë. Nuk i kujtojnë martirët. E kanë humbur kujtesën e Jezusit të Kryqëzuar, e vetmja kujtesë e jona”.

Duke përmendur episode nga dëshmitë, Papa Françesku vuri në dukje dy gjeste: atë të milicistit që i dha murgeshës një dardhë e, atë të gruas myslimane që i çoi katolikut për të ngrënë. Jemi të gjithë vëllazër, nënvizoi: “Edhe ai njeri mizor mendoj... unë nuk e di ç’mendoj, por ndjeu Shpirtin Shenjt në zemrën e vet e ndoshta, mendoj për të ëmën e tha: ‘Merre këtë dardhë e mos bëj zë!’”. E ajo grua myslimane i kapërceu ndryshimet fetare: deshi me gjithë shpirt. Besonte në Zot e bënte mirë”. Të gjithë kanë në vetvete farën e së mirës, theksoi Papa Françesku, për të kujtuar se këta tre dëshmitarë janë bij e bija nënash, kanë jetuar në familje, prej saj janë edukuar e kanë marrë guximin për jetën. Por tani, tha Papa, kopshti i jetës, familja, nuk lulëzon më si më parë. Ati i Shenjtë u kërkoi të gjithëve të luten për familjet, që të lindin shumë fëmijë e prej tyre, të shtohen thirrjet për t’ia kushtuar jetën Zotit. Së fundi, i tha klerit boshnjak se lufta, që kanë përjetuar, është histori mizorish, njësoj siç janë konfliktet e sotme nëpër botë. Dhe këshilloi: “Bëni gjithnjë të kundërtën e mizorisë. Silluni me ëmbëlsi, vëllazëri e falje. E mbarteni Kryqin e Jezu Krishtit. Kisha, e Shenjtja Kishë Nënë, ju do kështu: të vegjël, martirë të vegjël, para këtyre martirëve të vegjël, dëshmitarë të vegjël të Kryqit të Krishtit”.

George Frendo
Ipeshkëv

FIGURA E MESHTARIT NË DOKTRINËN E PAPË FRANÇESKUT

(Pjesa e parë)

“Mos të harrojmë se pushteti autentik është shërbim, edhe Papa, duke ushtruar pushtetin e tij, duhet të zbatojë atë shërbim që arrin kulmin e tij të shkëlqyeshëm mbi kryqin”.

Në një periudhë kur imazhi i meshtarit ishte bërë shumë i njollosur për shkak të skandaleve të pedofilisë nga ana e një numri meshtarësh në shumë vende të botës, Papa Benedikti XVI vendosi të shpallte Vitin e Meshtarisë. Në fjalimet e tij, si edhe në shumë fjalime të Kardinalit Hummes, atëherë Prefekti i Kongregacionit për Klerin, është shprehur qartë qëllimi i këtij viti: do të ishte një rast i veçantë që të gjithë meshtarët të reflektojnë mbi thirrjen dhe misionin e tyre, si edhe që të përtërijnë hirin e sakramentit të urdhrin të shenjtë që kanë pranuar. Pra duhej të ishte “rast për një kuptim më të thellë teologjik dhe shpirtëror” të meshtarisë (Kard. Hummes).

Gjatë pontifikatit të tij Papa Benedikti ka pasur shumë raste të flasë për nevojën që jo vetëm meshtarët, por edhe ipeshkvijtë të jenë mbarështues të denjë për misionin fisnik që u është besuar. Dhe Papa Françesku, gjatë këtyre dy viteve të pontifikatit të tij, nuk ka munguar të theksojë këtë detyrë, nganjëherë edhe duke përdorur një fjalor pak a shumë të fortë.

Në këtë ligjëratë do të flas shkurtimisht për shtatë tipare që, sipas Papa Françeskut, duhet të shkëlqejnë në figurën e çdo meshtari.

1. AUTENTICITET: Kjo do të thotë identitetin e vërtetë të meshtarit. Në Ungjijtë lexojmë disa herë se populli habitej duke dëgjuar Jezusin, sepse “fliste me autoritet, dhe jo si skribet e farisenjtë”. Me fjalë të tjera, meshtari duhet të jetë i besueshëm, jo shtiracak.

Në Meshën e Krizmës që Françesku kremtoi pak ditë pas zgjedhjes së tij si Papë, homelinë e mbylli me dy apele. Njëri u ishte drejtuar besimtarëve: “Qëndroni afër meshtarëve tuaj me



afekt dhe me lutje, që të jenë gjithmonë barinj sipas zemrës së Hyjit”. Tjetri u ishte drejtuar meshtarëve: “Hyji Atë përtërit në ne Shpirtin e shenjtërisë... Populli le të na shohë si nxënësit e Zotit, të vërejë se jemi veshur me emrat e tyre, dhe nuk kërkojmë asnjë identitet tjetër”.

Shën Pali e nxiti Timoteun ta ngjallë dhuratën e hirit që iu dha në saje të vënies së duarve. Papa komenton: “Kur mbarështimi ipeshvor, mbarështimi meshtarak nuk ushqehet me lutje, me dëgjesën e Fjalës së Hyjit, me kremtimin e përditshëm të Eukaristisë dhe me frekuentimin e sakramentit të Pendesës, përfundon në mënyrë të pashmangshme duke lënë në harresë domethënien autentike e shërbimit të vët dhe gëzimin që vjen nga bashkimi i thellë me Jezusin.” Dhe vazhdon: “Ipeshkvi që nuk lutet, ipeshkvi që nuk dëgjon Fjalën e Zotit, që nuk kremton çdo ditë, që nuk

shkon të rrëfëhet rregullisht, po ashtu edhe meshtari që nuk i bën këto gjëra, e humbasin bashkimin me Jezusin dhe bëhen i një mediokriteti që nuk është në dobinë e Kishës. Për këtë duhet t'u vijmë në ndihmë ipëshkvinjve dhe meshtarëve që të luten, që ta dëgjojnë Fjalën e Hyjit si ushqim të përditshëm, të kremtojmë çdo ditë Eukaristinë dhe të rrëfëhen rregullisht. Kjo është shumë e rëndësishme, pasi i përket pikërisht shenjtërisë së ipëshkvinjve dhe të meshtarëve” (Audienca Gjenerale, 26 mars 2014)

Dhe citoj fjalë për fjalë nga homelia e tij në meshën e krizmës e vjetshme: “Meshtari është më i varfëri i njerëzve në qoftë se Jezusi nuk do ta pasuronte me varfërinë e tij, është më i panevojshëm në qoftë se Jezusi nuk do ta thërriste mik, më i pamend ndër njerëz në qoftë se Jezusi nuk do ta udhëzonte me durim si Pjetrin, më i paafti ndër të krishterët në qoftë se Bariu i Mirë nuk do ta forconte në mesin e grigjës së tij. Askush nuk është më i vogël se sa një meshtar i lëshuar në fuqinë e tij të vetme” (17 prill 2014).

Në fjalimin që kishte përgatitur për takimin me meshtarët dhe rregulltarët në Katedralen e Tiranës (por që në fakt nuk e ka lexuar), ai na nxiti t'i japim çdo ditë “hapësirën e merituar Zotit, duke i kushtuar kohën, duke hapur zemrat, që Ai të veprojë në jetën tonë dhe misionin tonë... Dimensionin seditës bëhet i domosdoshëm, në mesin e punëve më urgjente e të rënda. E më shumë misioni ynë na thërret të shkojmë drejt periferisë ekzistenciale, më shumë zemra jonë e ndien nevojën e brendshme për të qenë e bashkuar me atë të Jezusit, plot mëshirë e dashuri”.

Dhe në Katedralen e Napolit ka tërhequr vëmendjen e meshtarëve që ta shmangin shpirtin e botës (*mondanità*), i cili “shkon kundër dëshmisë, ndërsa shpirti i lutjes është një dëshmi që shihet: shihet kush është ai burrë apo ajo grua që lutet, si shihet gjithashtu kush është ai që lutet formalisht por jo me zemër”.

Është shumë e lehtë të shmangim Liturgjinë e Orëve ose rruzaren dhe meditimin duke justifikuar vetveten sepse, themi, “Po punoj në të korrat e Zotit”. Por Zoti i të korrave ka përparësi mbi të korrat e Zotit.

2. DËSHMI DHE NDARJE GËZIMI: Papa Benedikti, në një fjalim për klerin e Romës, u tha meshtarëve: “Tregohuni si njerëz të lumtur sepse keni pranuar thirrjen meshtarake”. Më duket shumë e rëndësishme që meshtari jo vetëm të jetë i lumtur, por edhe të dëftojë gëzimin e tij, madje, sipas shembullit të Zojës Mari, të ndajë gëzimin e tij me

të tjerët. Anglezët thonë: *Long faces never make saints!*

Në *Evangelii Gaudium* Françesku bëri një vërejtje: “Ka disa të krishterë jeta e të cilëve duket si një stil Kreshme pa Pashkët”. Besoj se kjo vërejtje vlen edhe për shumë meshtarë, ekspertë më shumë se profeti Jeremia për të shkruar “Vajtimet”.

Tërë homelinë në Meshën e Krizmës së vjetshme ia kushtoi gëzimit të meshtarëve. Tha se “gëzimi i meshtarit është një e mirë e çmueshme jo vetëm për të, por edhe për të gjithë besimtarët, popullin e Zotit”. Dhe “ai që është i thirrur di që ekziston në këtë botë një gëzim i vërtetë dhe i plotë”. Thotë gjithashtu se gëzimi meshtarak ka tri karakteristika: “*Është një gëzim që na lyen*. Që do të thotë, një gëzim që ka hyrë në brendësinë e zemrës sonë dhe e ka konfiguruar dhe forcuar në mënyrë sakramentale... *Është një gëzim i pakorruptueshëm*. Tërësia e dhuratës, të cilën askush nuk mund ta largojë as ta shtojë aspak, është burim gëzimi... *Është gëzim misionar*. Gëzimi i meshtarit është në marrëdhënie intime me popullin e shenjtë dhe besnik i Zotit.”

Por bën edhe një vrojtim: gëzimi i meshtarit duhet të ketë një dimension “baritor”. Thotë se ky gëzim “rrjedh vetëm atëherë kur bariu është në mesin e grigjës së tij... Për këtë është një gëzim që mbrohet nga e njëjta grigjë. Edhe në momentet e trishtimit... populli i Hyjit është i aftë ta ruajë gëzimin tënd, është i aftë të të mbrojë, të përqafojë, të ndihmojë që ta hapësh zemrën për të rigjetur një gëzim të përtërirë.

3. THJESHTËSI: Edhe pse meshtari dioqezan nuk ka bërë kushtin e varfërisë si në rastin e rregulltarëve, megjithatë vetë natyra e jetës së tij kërkon që ai të përjetojë një formë jetese të thjeshtë e të varfër. Në fakt Konkili II^e i Vatikanit, në Dekretin mbi mbarështimin dhe jetën e Meshtarëve *Presbyterorum Ordinis* (n. 17) tha se ata “janë të grishur ta përqafojnë varfërinë e vullnetshme, me anë të së cilës mund të bëhen si Krishti në një mënyrë më të dukshme dhe të jenë më të gatshëm për mbarështimin e shenjtë”. Dhe Papa Françesku thotë se edhe pse meshtarët dioqezanë “nuk e bëjnë kushtin e varfërisë, por duhet ta kenë shpirtin e varfërisë” (në Katedralen e Napolit). Besoj se të gjithë jemi dakord se një jetë e thjeshtë, pa luks, personin e meshtarit e bën më të besueshëm. E dimë se një nga arsyet pse Papa Françesku menjëherë tërhoqi admirimin e popujve ishte pikërisht thjeshtësia e tij.

Françesku e çmon varfërinë e meshtarit si kusht

për gëzimin e shpirtit (Mesha e Krizmës, 17 prill 2014) dhe burim i një lirie të veçantë: “Sa skandale në Kishë dhe sa shumë mungesa të lirisë për parà: 'Unë këtij personi duhet t'i them katër të vërteta, por nuk mundem pasi që është një bamirës i madh'. Bamirësit e mëdhenj bëjnë jetën që duan dhe unë nuk kam liri t'u them, sepse jam ndeshur me paratë që ato më japin” (në Katedralen e Napolit).

Njëkohësisht vëren se “shpirti i varfërisë megjithatë nuk është shpirti i mjerimit. Një meshtar, që nuk i ka bërë kushtet e varfërisë, mund të ketë edhe kursimet e tija, në mënyrë të ndershme dhe të arsyeshme. Por kur i ka këto lakmi dhe i kthen në biznes...” (ibid).

4. SHËRBËTOR I POPULLIT: Jo vetëm fjalët, por edhe shembulli i Françeskut na mësojnë domethënien e mbarështimit meshtarak si shërbim. Në Shkrimin e Shenjtë titulli “shërbëtor” ishte titull nderi. Quheshin “shërbëtorë” ata që udhëhiqnin popullin si Moisiu, ata që flisnin në emrin e Zotit si Isaia. Jezusi vetë quhet “shërbëtor”; Maria quan vetveten “shërbëtoreshë”. Edhe në politikë përdoret fjala “ministër”, që do të thotë “shërbëtor”. Por ndërsa në politikë ky titull është thjesht një titull, për ne ky titull tregon misionin tonë.

Në meshën e inaugurimit të misionit të tij si ipeshkvi i Romës Papa Françesku tha: “Mos të harrojmë se pushteti autentik është shërbim, edhe Papa, duke ushtruar pushtetin e tij, duhet të zbatojë atë shërbim që arrin kulmin e tij të shkëlqyeshëm mbi kryqin. Duhet të frymëzohet nga shërbimi i përvuajtur, konkret dhe besnik i shën Jozefit... duhet t'i hapë krahët e vet për të ruajtur gjithë njerëzimin, veçanërisht më të varfrit, më të dobët, më të parëndësishmit të uriturit, të eturit, të huajt, të zhveshurit, të sëmuret dhe të burgosurit”.

Në meshën e krizmës së vitit 2013, duke i kujtuar meshtarët se janë lyer me krizmën e shenjtë, i kujton gjithashtu lyerjen e Krishtit.

Këtu Papa kujton atë pjesë nga Isaia, që Jezusi lexoi në Sinagogën e Nazaretit: “Shpirti i Zotit është mbi mua sepse Ai më shuguroi! Ai më dërgoi t'u kumtoj të vobektëve Ungjillin, t'u shpall robërve çlirimin, të verbërve dritën e syve; t'i lëshoj në liri të ndrydhurit, të shpall vitin e hirit të Zotit”. Dhe komenton: lyerja e Jezusit “është për të varfërit, për të burgosurit, për të sëmuret dhe për ata që janë të mërzitur dhe vetëm. Lyerja nuk është për të parfumosur vetveten”.

Dhe në të njëjtën meshë, se duhet të përjetojmë bashkimin tonë me Krishtin dhe të marrim pjesë në autoritetin e tij e në veprën e tij shëlbuese vetëm duke afruar periferitë, ku do të shohim vuajtje, gjak të derdhur, verbëri që dëshiron të shohë, skllevër të dominuesve të këqinj (ibid).

Jeta meshtarake përfshin dëshirën “për tu shërbyer të tjerëve në gjëra që puqen nga Zoti, dëshira për të qenë gjithë jetën në shërbim për të dhënë katekizëm, pagëzimin, sakramentin e faljes, për të kremtuar Eukaristinë, dhe për të shëruar të sëmuret” (Audienca e përgjithshme, 26 mars 2014).



Don Lush GJERGJI

Prishtinë

OSCAR ROMERO (1917 – 1980),
MARTIR I LIRISË DHE DEMOKRACISË

(Pjesa e parë)


“Të lumët ju kur t’ju shajnë e t’ju salvojnë dhe kur, për shkakun tim, t’i thonë të gjitha të zezat kundër jush, por në rrenë! Gëzohuni e galdoni, sepse i madh do të jetë shpërblimi juaj në qiell! Jo po, kështu i salvuan edhe profetët para jush!” (Mt 5, 11-12)

“Nuk është e përndjekur Kisha, por populli. Meqë është Kisha në anën e popullit, edhe populli në anën e Kishës, ajo është pjesë e përndjekur me popull... Unë e di se lufta e popullit tonë është puna e së vërtetës dhe drejtësisë, edhe pse më urrejnë shumë në vendin tim për shkak se i mbroj të varfërit dhe nëpërkëmburit... Pozita ime baritore më detyron të jem solidar me të gjithë ata që vuajnë, të mbështes çdo përpjekje drejt lirisë dhe dinjitetit njerëzor... Asgjë nuk është më e rëndësishme se sa jeta njerëzor... Pashkët janë thirrje e fitores. Askush nuk do të mund të shuajë atë jetë të cilën e ringjalli Krishti, dhe se askurrë nuk do të mund të ngadhënjëjnë vdekja dhe urrejtja: Krishti është ngadhënjimtar!”

Oscar Arnulfo Romero u lind më 15 gusht 1917 në Ciudad Barrios, vend i vogël në Salvador, afër kufirit me Hondurasin. Familja e tij ishte e varfër dhe jetonte nga puna modeste e të atit; pranë shtëpisë së tyre të vogël kishin pakë tokë dhe bagëti. Me siguri se edhe Oscar do të vazhdonte traditën familjare, mirëpo ishte me shëndet të lig, i paralizuar qysh kur kishte vetëm shtatë muaj. I ati ishte telegrafist, kurse e ëma amvise. Oskari i vogël gati se në gjithçka trashëgoi të atin e vet në punë, mësoi të shkrim-leximin, të luante me flaut, ishte i mahnitur pas teknologjisë telefonike.

Nuk dihet pse dhe si hyri në seminar. Disa thonë se për këtë vendosën bashkëvendësit e tij, për të pasur mundësi ai të bëhet meshtar i tyre vendor. Të tjerët thonë se pranë dëshirës së prindërve dhe vendasve, edhe ai vet dëshironte të bëhej meshtar, gjithsesi i shtyrë edhe nga rrethanat e jetës dhe sëmundja... Një gjë është e sigurt: Zoti është shërbye me këto apo rrethana të ngjashme dhe e solli që t’i shërbejë. Shpenzimet e seminarit ishin të mëdha, kurse i ati nuk ishte në gjendje këto t’i paguajë. Për këtë Oscar ishte i detyruar të braktisë seminarin pas një kohe të caktuar, e të punoj si minator, me këtë t’i ndihmojë familjes, por edhe vetvetes. Puna e minatorit ishte shumë e rëndë dhe mjaft e rrezikshme. I riu Oscar, mendonte gjithnjë dhe e ëndërronte seminarin, mësimin, lutjen, meditimin dhe pikërisht shkakun i kësaj ishte mjaft i lënduar, pak edhe i dëshpëruar në jetë. Koha kalonte dalngadal dhe në monotoni...

Edhe kjo gjendje fatbardhësisht përfundoi mirë. Rektori i seminarit San Migueli kishte mirëkuptim dhe mëshirë ndaj familjes Romero, kështu që lejoi kthimin e Oscarit në seminar edhe atë pa pagesë. I riu ishte i lumtur me këtë shenjë të mirësisë, dashurisë dhe bamirësisë. Që të kthente disi këtë dashamirësi, ishte i angazhuar thellësisht në jetën e përshtirësisë, në lutje, në mësim dhe ndryshim të sjelljes, në



gjithçka. Ishte i gjithanshëm: luante në piano, shkruante poezi, lexonte, mësonte, organizonte jetën kulturore, ishte shumë i gjallë dhe i lumtur. Më në fund gjeti veten dhe thirrjen e tij të vërtetë!

Pikërisht kjo gjallëri intelektuale, sjellja e mirë shpirtërore dhe materiale në seminar, ishin “vizë” për studime në Romë. Banoi në institutin Latino-amerikan të cilin e drejtonin etërit jezuitë, kurse studionte në Gregorian. Roma do t’ia hapë edhe më tepër mendjen dhe zemrën dhe do t’i ofrojë përvojën e jetesës së përditshme të katolicizmit. Studenti i ri i

teologjisë Oscar ishte tejte i lumtur, i dhënë pas studimeve dhe jetës shpirtërore, me plot përgjegjësi, thuajse gati edhe më tepër se moshatarët e tij. Në veçanti ishte i mahnitur me studimin e historisë së Kishës së San Salvadorit dhe i dashuruar në një mënyrë në thirrjen meshtarake.

“UNË JAM MESHTAR PËR VUAJTJE DHE PARAQITJE”

Lufta e Dytë Botërore nuk e kurseu as Romën. Gjatë Luftës më 4 gusht 1942 Oscar Romero realizon ëndrrën jetësore, bëhet meshtar i Kishës së Krishtit. Ja si e mendoj meshtarinë i riu, Don Oscar Romero: *“Të jesh meshtar do të thotë para të gjithave të ndash kryqin e Krishtit dhe vuajtjen me popullin e Zotit... Vuajtja është sikur hija e duarve të Zotit e cila bekon dhe falë. Për këtë dhembja bashkon, i bënë njerëzit mes veti solidarë dhe i afron te Zoti... Unë jam meshtar për vuajtje dhe paraqitjen e jetës sime Zotit, Kishës, popullit, të gjithëve, edhe atë me dashuri...”*

Me plotë zell apostolike, me njohuri dhe përgatitje të mirë filozofiko-teologjike, por edhe më tepër i pasuruar shpirtërisht, Don Oscar Romero kthehet në atdheun e vet. Gjendja në Salvador ishte shumë e ndërlikuar dhe tendosur me regjimin diktatorial të Fulgencie Batisste-s.

Në vend të mirëseardhjes, Don Romero dhe një mik i tij po ashtu meshtar me të cilin udhëtoi, qenë të burgosur si kinse spiunë, dhe vetëm pas shumë mundimeve, nënçmimeve dhe ndërmjetësive qenë liruar. Ndeshja e parë me realitetin e atdheut ishte shumë e mundimshme dhe e rëndë. Kryqi nuk do t'i mungojë asnjëherë.

Don Romero u emërua shpirtëror ndihmës dhe sekretar personal i ipeshkvit, derisa miku i tij u emërua vikar gjeneral i ipeshkvisë. Me jetën dhe fjalët e tij publike, zemrën e tij të madhe dhe bujare, shumë shpejt fiton besimin e ipeshkvit, të klerit, të popullit, në një mënyrë bëhet apostull i të përvuajturve, të varfërve, mik dhe vëlla i të vuajturve.

Gjatë Koncilit të Dytë të Vatikanit, Don Oscar Romero është emëruar monsinjor dhe sekretar i Konferencës Ipeshkvore të Salvadorit. Kjo emërim e detyroi ta braktiste San Miguelin, ipeshkvin e tij, punën pastorale, në veçanti me rini dhe me familje.

Më nuk ishte i ri, kishte 50 vjet, me plotë përvoja, por shëndet jo të mirë, megjithatë duke mos u kursyer asnjëherë.

Në rrethin dhe detyrën e re erdhi në shprehje saktësia e tij në punë, këmbëngulësia në ndërmarrje katekistiko-pastorale, idetë e thella në mësimdhënie, përzemërsia dhe sinqeriteti i komunikimit me të gjithë.

Pas tre vjet pune (1970) është emëruar edhe Sekretar Gjeneral i Konferencës Ipeshkvore të Amerikës së Mesme, një obligim dhe detyrë e rëndësishme dhe e lartë. Mirëpo, ai edhe me këtë emërim nuk e “humbë kokën”, porse edhe më tutje mbeti krejt i thjeshtë, përvuajtur, i bindur se është i ftuar të shërbente në

dashuri dhe nga dashuria në kërkim të së mirës së përgjithshme.

LUFTËRAT SHOQËRORE

Kush është në të vërtetë Oscar Arnulfo Romero? Çfarë në të vërtetë do të thoshte për te të jesh ipeshkëv dhe bari i Kishës Katolike në Salvador, pas Koncilit të Dytë të Vatikanit, atje ku mbretëronte varfëria, padrejtësia, diskriminimi, diktatura, vrasjet dhe shfrytëzimi i popullatës. Përse dhe kush e vrau në altar? Çfarë na mbetet sot nga jeta, mësimi dhe martirizimi i tij? Pse fliste, besoi dhe mësoi: *“Vuajtja e skamnorëve është vuajtja e vet Krishtit?”* Përse ishte në anën e të vegjëlve, të shtypurve, të shkelurve, edhe pse e dinte se kjo është shumë e rrezikshme?

Përzgjedhja dhe përcaktimi i tij ishin të pashmangshme, çështje ndërgjegjeje, edhe më tepër pyetje e fesë, bindjes, jetës, dëshmisë së krishterë. Ky përcaktimi i guximshëm do e sjell deri te martirizimi, do e bëjë bashkëpjesëmarrës të vdekjes dhe ngjalljes së Jezu Krishtit.

Selia e Shenjt njëh në mons. Oscar Romero-n njeriun e vlefshëm të Kishës dhe për këtë e emëron ipeshkëv ndihmës të San Salvadorit.

Rrethanat shoqëro-politike janë tepër të komplikuar dhe rrezikshme, ato kishtarë të pasigurta, të ndara në dy rryma apo drejtime: njëra pro-shtetërore, tjetra popullore, me këtë anti-shtetërore.

Ipeshkvi i ri, është ende i pavendosur, mendon, mediton, lutet, do të dëshironte të këshillohej me të gjithë, të njohë sa më mirë realitetin, për të pasur mundësi që më mirë dhe lehtë të përcaktohet për qëndrim të drejtë dhe ungjillor. Disa shohin rrezik vetëm nga e majta, nga komunizmi, kurse të tjerët vetëm nga e djathta – diktatura e pasanikëve, të cilët e konsideronin veten të krishterë, mirëpo, fatkeqësisht nuk ishin të tillë edhe me jetë.

Në vitin 1974 Mons. Romero është emëruar ipeshkëv rezidencial në Santiago de Maria, qytet dhe ipeshkvi në periferi. Menjëherë filloi me vizita baritore, që për së afërmi dhe për së drejti të njihet me nevojat e popullit, me botën e varfër, me mungesën e lirisë dhe dinjitetit njerëzor, drejtësisë, shkollimit, kulturës, me të gjitha. Shpeshherë thoshte: *“Kjo qeveri nuk ka asgjë të mirë, përpos vuajtjes dhe durimit, besimit për një të ardhme më të mirë.”*

Kleri në pjesën më të madhe është me popullin dhe për këtë përjeton përndjekje të rënda diktatoriale. Përndjekjet dhe vrasjet janë gjithnjë e më të shpeshta. Pesë besimtarë janë të prerë nga grupet ushtarako-policore kombëtare në njërin nga famullitë e tij. Mons. Romero proteston ashpër kundër kësaj veprë të tmerrshme, kërkon drejtësi për të gjithë; ai nuk u ndal me kaq, por bëri edhe një hap më tutje, sulmoi dhe fajësoi regjimin totalitar i cili ngufatë lirinë e popullit. Edhe më shpesh vizitonte famullitë e tjera, kremtonte me popull eukaristinë, predikonte fjalën e Hyjit, kërkonte dhe lutej vazhdimisht për liri, trimëronte popullin...

Don Nosh Gjolaj
Podgoricë

MIRËNJOHJA E TË DREJTËS - SHOKUT TË MARTESËS

(Pjesa e tretë)

6. Të tejkalohet (mposhtet) egoizmi

Njeriu, i cili merr guximin për ta mposhtë frikën, ai do të ketë guxim për ta mposhtë edhe egoizmin. Frika nuk është asgjë tjetër përveç motra e egoizmit. Frika gjithherë sillet rreth një boshtit, dhe ai bosht nuk është asgjë tjetër përveç egoizmi. Antipodi i egoizmit është altruizmi. Në qoftë se kemi theksuar, se dinjiteti ec së bashku me devocionin e thjeshtësisë (përlësisë), atëherë mund të themi me të drejtë se dinjiteti e tejkalon egoizmin, dhe merr mbi vete guximin e përgjegjësisë, duke e shkund frikën personale. Përderisa egoizmi vepron në të kundërt, sepse egoisti i mungon dinjiteti, thjeshtësia (përlësia), guximi, përgjegjësia. Pasigurinë e vet, e shpreh nëpër mes mendjemadhësisë (kryeneçësisë), mendjelehtësisë, me një fjalë fryhet si gjel deti. Egoist në qoftë se përulet, ai këtë e bënë në mënyrë instinktit si kafsha e cila e nuhat rrethi ose mjedisin e rrezikshëm.

Altruisti jo vetëm se posedon dinjitetin, por është i vetëdijshëm se nuk është i vetmi në botë, por përkaj tij jetojnë edhe tjerët. Njeriu si i tillë është uniket me gjitha virtytet dhe të këqijat që i bartë me vete. Por orvatet dita-ditës për ta fisnikëruar unin e vet, që e ruan si sytë e ballin. Nuk lejon të shkrihet as të shkelet uni (egoja), po ashtu e respekton uni (egoje) e tjetri, duke dhen kurajë dhe duke ndihmuar me gjitha fuqitë njerëzore për t'ia arrit qëllimin e përbashkët. Altruisti

posedon të njëjtën kohë vetëdijesimin e plotë vetes dhe vetëmohimi i egoizmit. Ai e gjë kënaqësinë dhe drejtpeshimin e jetës në vlerat e larta morale në vetëmohimin e përditshëm, jo vetëm se mposhtë egoizmin por edhe begaton tjetrin, përkaj vetes. Dialektika e tillë ia mundëson baraspeshën e jetës, që e shoqëron optimizmi që sill shumë fryte, jo vetëm për bashkësinë martesore por edhe shoqërisë e gjerë.

Sot i mungon njeriut vetëmohimi, flijimi, përvujtëria asketike. Çdo kryq apo ndonjë peshë e rënd që e sillë jeta e përditshme, atë e tjetërso. Karakteristika e njeriut të sotme është në kënaqësinë e trupit, epshit, hedonizmi i plotë, që kurrë nuk i sill njeriut jo vetëm fatlumturi por as kënaqësi të përhershme. Nuk është për t'u habitur kur shohim në çdo hapë kufomat e gjalla që ende lëvizin duke vegjetuar në vorbullën e drogës apo alkoolit apo ndonjë topitje tjetër. Që nuk është asgjë tjetër përveç rrethi magjikë apo djallëzuar që buron nga egoizmi. Përderisa antipodi i egoizmit, altruisti është gjithherë në veprim, me principin e jetës. Ata që bëjë edhe do ta ketë jo vetëm bashkësia e martesës por edhe shoqëria në tërësi. Pikëpamjet e tija janë në sistemin e vijëz horizontale që kryqëzohet me vijën vertikale. Me tjera fjalë, njeriu i tillë është i lidhur me lartësinë e qiellit dhe njëherë me vijën horizontale që ndërlikohet në mënyrë aktive me botën e përditshme. Njeriu që e

m p o s h t ë
egoizmin, ai e
t e j k a l o n
vetveten dhe
ndërron edhe
sipërfaqen e
tokës. Të gjitha
sukseset që i
kemi sot burojnë
nga altruizmi i
njeriut që ia ka
arritur me dalë
në hënë, në
h a p ë s i r ë n
qiellore, mos
flasim për fizik,
m a t e m a t i k,
medicinë etj.
Njeriu i tillë
është jo vetëm
krijues por edhe
burimor, që e
f i s n i k ë r o n



kulturën, kombin, fenë dhe mos flasim për bashkësinë e martesës. Njeriu i tillë është i vetëdijshëm se është partner i Zotit, dhe bashkë punojnë dhe veprojnë për krijuar botën e re (Mbretërinë e Zotit). Kjo është edhe detyra kryesor e çdo çiftit martesor. Nuk ka bashkësi martesor aty ku mbretëron egoizmi, por fatkeqësisht aty do të mbretërojë steriliteti (shterpësia) që sillet rreth vetes, ndërsa botës (mjedisit apo bashkësisë martesore) i sjellë asgjë të mirë përveç vdekjeprurësën e bashkësisë martesore. Ata të cilët mendojnë për të hyrë në bashkësinë e martesës, duhet që nga fillimi të zhveshën nga egoizmi dhe të veshën me altruizëm, ashtu do t'iu çetel rruga jo vetëm e Zotit, por edhe e partnerit.

7. Njeriu është më i madh se sa mendon

Altruisti është njeriu i çelur, i hapur, i cili e tejkalon jo vetëm veten, por është shumë më i madh se sa mendon. Sot shumë pak çmohet njeriut. Siç thotë një proverb: “Njeriu i shekullit XIX e vret Zotin, derisa njeriu i shekullit XX e vret njeriun!” Ndoshta shumë pakë jemi të vetëdijshëm për këtë faktin, se sot njeriu është instrument qoftë i ideologjisë, fundamentalizmit, teknikës, me një fjalë robot përskaaj robotit i kompjuterizuar. Njeriun, sot e kërkojmë aty ku nuk është!

a) E mendoj dinjitetin e ardhshëm në njeriun e thjesht

Një student nga familja e mirë, posa u regjistruar në fakultetin e medicinës, filloi të shoqërohet me shoqërinë e dobët. Filloi t'i lërë pas dore detyrimet, obligimet, llogarit, dhe asnjë qortim më nuk i merret seriozisht. Ishte plot vete. Një prej ditëve një këshilltar i mirë, e qortoj me këto fjalë: “Mendoje mjekun e ardhshëm në personin tënd!” Një gjest i tillë e shqetësoi studentin. Asnjëherë në lidhje me profesionin e vet nuk ka menduar, si do të duket në rrolin e mjekun të ardhshëm. Biseda i ndihmoi. Djali ishte si çdo student. Ende nuk është mjek, por e sheh vetveten në rrolin e mjekut të ardhshëm, dhe filloi të veproji nën këtë prizëm. Për studentin e ri ishte ky motiv i mjaftueshëm.

Dinjiteti i njeriut ndërlidhet ngushtë me personin (unin), dhe zhvillohet gradualisht shkallë-shkallë, ashtu siç zhvillohet edhe vetë njeriu. Kishte me qenë e gabueshëm po qe se mendojmë se mund ta blejmë në pjacë, në shitore apo diku gjetiu, apo mund edhe ta veshim siç e veshim veshjen solemne për dasmë apo ndonjë festë tjetër! Me zhvillimin e njeriut dhe vetëdijesimin e tij, arrihet edhe dinjiteti, nëpër mes të cilës e tejkalon edhe veten. Njeriu altruist është shumë më i fortë se mendon, posedon atë fuqinë e

pashtershme. Antipodi i saj është egoizmi, që reflektohet në mungesën e dinjitetit, i cili e reflekton zbrazëtinë e vete nëpër mes kamuflimit apo stolisjes së fytyrës së mendjelehtësisë apo kryeneçësisë, me fjalë shumta, bombastike, zakonisht i quajmë tipat e tillë “zhurmmaxhi”(zhurmëtar).

Për ta tejkaluar vetveten është e nevojshëm motivimi, posaçërisht për njeriun e ri. Bie fjala, për djaloshin e ri është një motivim mjaftë i fortë, në qoftë se ai e sheh veten në rrolin e babës (bashkëshortit) të ardhshëm. Si i tillë do të ruhet nga tundimet e llojllojshme që e sill jeta e përditshme. Ai e ka të qartë idealin, në këtë rast me qenë bashkëshort i mirë edhe pse është në rrugën e zhvillimit, por më lehtë i kundërvihet mashtrimit hedonist! Po ashtu e njëjta gjë vlen edhe për vajzën e re, e cila motivohet në rrolin e bashkëshortes (nënës) së ardhshme. Një motivim i tillë i jep atë energjinë e brendshme për t'u ballafaquar me realitetin e jetës. Dinjiteti i nënës së ardhshme nuk e lejon ta çorodisë natyrën e femrës. Ajo e tejkalon edhe vetveten. Njeriu, i cili posedon motivin e mjaftueshëm, ai sillet edhe pa dashje në mënyrë serioze. Në këtë rast aktivizohet edhe nënvetëdija apo pavetëdija (nëndhesja psikike) për t'ia arritur cakun (ideal) njerëzor! Jo vetëm se unë dëshiroj të behëm nënë e mirë apo babë i mirë, por edhe mjedisi e ka një bindje të mirë për mua, atëherë edhe pa dashje mundohem të sillem në mënyrë korrekte dhe dinjitoze. Si fjala vjen, vajza e cila është nënshtruar me mendimit komercial dhe është bërë objekt i tjetrit, ajo kur të vetëdijesohet, do t'i turpërohet vetvetes! Po ashtu frustron, se si mund të kërkojë nga fëmija një gjë të shenjtë, përderisa ti si vajzë e re nuk je përmbajtur!

Për dikën është motiv i mjaftueshëm, ta shoh veten në rrolin e edukatorit të ardhshëm. Sepse edukatori i ka fëmijën para vetes, të cilët nesër do të rriten dhe do ta marrin pushtetin në dorë. Po ashtu mund ta shohim veten në rrolin e partnerit, i cili përgatitet për martesë, duke motivuar veten me një vetëbesim, shpresë, vetëdijesim për t'ia krijuar vetes dhe tjetrit ardhmen e fatlum.

Njeriu është më i madh dhe madhështor. Këtë duhet ta kenë parasysh jo vetëm edukatorët por edhe çifti martesor, i cili jeton me tjetrin dhe përskaaj tjetrit, jo si dy bota të ndara (Marsi dhe Afërdita) por si dy botë që gërshetohet njëra me tjetrën dhe plotësohen. Çdo njëri prej partnerëve është i vetëdijshëm se para vetes e ka individin tjetër, që është i tërësishtëm, nëpër mes të cilit edhe ai realizohet si baba apo si nënë. Në qoftë se mbretërojnë këto principe në jetën e bashkësisë martesore, atëherë duhet pa kusht të respektohet tjetri, ashtu siç është, po ashtu duhet pa kusht të ruhet dinjiteti dhe uni (egoja). Por së bashku në mënyrë të ndërsjellët duhet të begatohen partnerët

mes vetes nga thesari i brendshëm. Begatimi i ndërsjellës duhet të vazhdoj deri në vdekje, për të cilin begatim nuk ka pushim!

b) Kërkoj mbretin në tjetrin

Shpeshherë ndodh se shqetësohemi për gjerat e imta dhe boshe, si fjala vjen, bashkëshortja apo bashkëshorti e bënë një gjest të vogël por pa vend. Menjëherë bashkë partneri e humb durimin dhe fillon të shamatohet, duke përdor fjalorin e ndytë, dhe sjellja e tij ose asaj është si një njeriut të çmendur dhe i papërmbajtur. Për një gjë të vogël e humb dinjitetin jo vetëm në sytë e bashkëshortes (bashkëshortit) por edhe në sytë e familjes dhe të mjedisit.

Ja një shembulli i mbretit Prusisë: Friderik Vilhemi IV, nga natyra ishte hidhërak, që shpërthente shumë shpejt dhe i papërmbajtur. Një ditë shqetësohet shumë për një çështje të vogël. Në atë moment bashkëshortja (mbretëresha) hyrë në dhomën e tij, menjëherë ajo e vëren mbretin se e ka fytyrë e vrazhdë. Filloi të ec nëpër dhomë kinse diçka po kërkon. Mbreti nuk mund të përmbahet dhe filloi të piskas në bashkëshorten: “Çka kërkon?” “Zotëri, po kërkoj mbretin në njeriun e thjeshtë!”, i përgjigjet. Aq ndikoj në të, sa që mbreti u hesht dhe mbeti pa fjalë. Ai, mbret dhe nga fytyra e tij madhëror nuk reflekton dinjiteti mbretëror. Atëherë si mund ta shohin tjerët njeriun në mbretin e Prusisë. Mos flasim se si mund atëherë një mbretë ta sundoj një popull të tërë kur nuk mund vetveten ta frenoj!

Shembulli në fjalë vlen jo vetëm për mbretin e Prusisë, por edhe sot e kësaj dite për çdo çift martesor. Njeriu si i tillë është krijesë më madhështore e Hyjit. Por ai duhet pa ndërpre për ta gjetur baraspeshën e jetës, i cili ndërtohet nëpër mes dinjitetit, sinqeritetit, virtytit, lirisë dhe altruizmit, që e tejkalon veten dhe mjedisin. Me një fjalë reflektohet uni i personit të pjekur. Ja rasti i dytë, njeriut të pjekur, është shembulli i Abauzit shkencëtar nga Gjeneva, i cili për 27 vite me radhë e mate barometrin, pamjet atmosferike dhe i shënonte nëpër copa letrave, dhe i vendos në tryezën e punës. Një ditë prej ditëve shërbëtorja, duke pastruar dhomën e tij, ajo i merr ato letra dhe i gjuan. Shkencëtari e pyeti shërbëtoren: “Ku i ke vendos ato copëzat e letrave?” “Zotëri, i kam hedh në furrën e zjarrit, ishin të ndyta dhe pa vlerë!” përgjigjet shërbëtorja. Shkencëtari e frenon veten, i kryqëzoi duar dhe u ulë në ulëse dhe tha në mënyrë të heshtjes: ”Mundin dhe djersen e 27 viteve i ke hedh në zjarr! Por të lutem të dytën herë mos prek ndonjë letër nga dhoma e punës!”

Rastet e shumta, njeriu i humb nervat, humb drejtpeshimin dhe taktin, dhe fillon si kafsha e egër dhe e plagosur të bërtas si i çmendur.

Sot mjaft të theksohet barazia mes njerëzve, barazia mes partnerëve, po ashtu të theksohet dinjiteti dhe madhështia e njeriut. Pamja mbretërore simbolizon njeriun e pavarur me karakter të fortë dhe dinjitoz, ashtu duhet çdo çift martesor për ta kërkuar në tjetrin pamjen mbretërore, nëpër mes të cilës do t'i arrinin deri te thellësia e zemrës së tjetrit. Dyert e zemrës në këtë rast janë gjithëherë të çelura apo të hapura për tjetrin.

c) E nderoj mbretin në njeriun e thjeshtë

Misionari i njohur Flaman, atë Damiani nga shekullin i kaluar, e befasoj botën e atëhershme, i cili nuk shikoi dallimet filozofike, fesë, gjuhës, kulturës. Shkoi në ishullin Molokaj, ku jetonin vetëm gërbulurit. Prej preventivës higjienike, i sillleshin të gjithë gërbulurit në këtë ishull. Ati Damian ishte i vetmi njeri, i shëndoshë mesin e gërbulurve. Jetoj me ta plotë 16 vite me një kënaqësi dhe me një natyrë optimiste, duke dhënë edhe tjerëve optimizmin, shpresën e jetës, me fuqi mbinjerëzore edhe në fund e rrëmbej gërbula. Edhe pse plot me gërbul, ai punoj me atë elan dhe kënaqësi, që nuk mund askush t'ia mposhtin atë fuqinë e brendshme, që ishte diçka mbi njerëzore, që ishte vetëm mirësia dhe dashuria e mishëruar në të. Vdiq më 15 prill 1889. Bashkë vuajturit e tij me vetiniciativën e çelin varrin te lisi, nën të cilin vend, ai pushonte netët e para, kur kishte ardhur në mesin e tyre. Mbreti Anglez Gjergji (Georgi) i V, në atë vend vendos një përmendore me nënshkrim: *“Dashuria më e madhe që ndokush mund të tregojë është: të japë jetën e vet për miqtë e vet”* (Gjon 15,13). Kuvendi i Havajit, e shpallë varrin e tij përmendore nacionale, përderisa vaporet ushtarake Amerikan, që kalojnë aty pari, në kujtim “heroit të dashurisë” e shprehin përshëndetjen, që i jepet vetëm përfaqësuesve dhe burrave të shteteve apo qeveritareve.

Vetëdijesimi i njeriut për dinjitetin që e posedon nuk është as në gjak, as në gjuhë, as në kulturë, as në rasë, as në trashëgim, por është vetë, personi - unikët, i cili e tejkalon vetveten duke u ngrit në fronin e lartë të dashurisë.

Një princip i tillë duhet gjithëherë të mbretëroi edhe në gjirin e bashkësisë martesore, duke kërkuar dhe nderuar mbretin në njeriun, në tjetrin, në partnerin e martesës. Dashuria e sinqertë kalon në heroizëm dhe trimëri, duke tejkaluar pengesat dhe ndalesat me atë fuqinë mbinjerëzore. Që nuk është asgjë tjetër për veç një baraspeshë e njeriut në botën e sotme, i cila është mjaft hedonist, egoist, vetjak dhe nuk i sill asgjë tjetër botës (bashkësisë) përpos sterilitetin dhe vdekjeprurësen e tij nga varësia epshit vetjak.

Don Pren Kola
Zvicër

FJALORI LITURGJIK

Aleluja, e cila del me këtë tejshkrim në gjuhën shqipe, sipas parimit fonetik rrjedh nga hebraishtja, gjuha e Dhiatës së Vjetër, הַלְלוּ יְהוָה (hallelu-Jah).

Porsi “Amen” dhe “Hosana”, edhe fjala “Aleluja” rëndom lihet e papërkthyer në liturgjinë e krishterë thuajse në çdo gjuhë, duke përshtirë këtu edhe gjuhën shqipe. Në fakt, mospërkthimi i saj dëfton mirë edhe rëndësinë e saj. Në Shkrimin e Shenjtë përdoret shpesh: (krhs. Tob 13,18; Ps 104,35; 105,45; 106,148; 111,1; 112,1; 113,1.9; 115,18; 116,19; 117,2; 135,1.3.21; 146,1.10; 147,1.20; 148,1.14; 149,1.9; 150,1.6; Sir 51,12; Zb 19,1-4.6). Në Besëlidhjen e Vjetër e gjejmë një herë në librin e Tobisë dhe njëzetekatër herë në Psalme. Vetë psalmet 113 deri 118 quhen hallel. Te Besëlidhja e Re e hasim katër herë në librin e Zbulesës 19,1-7:

Pastaj dëgjova [d.m.th., Gjoni] diçka si zë të fortë të një shumice të madhe që brohoriste në qiell: Aleluja! Shëlbim, lavdi dhe pushtet Hyjit tonë, sepse gjyqet e tij janë të vërteta dhe të drejta! ... Përsëri thanë: Aleluja! Atëherë njëzet e katër udhëheqësit dhe katër gjallesat ranë përmbys dhe e adhuruan Hyjin që rri në fron e thanë: Amen, Aleluja! Pastaj nga fronti jehoi zëri që tha:

Lavdërojeni Hyjin tonë, të gjithë shërbëtorët e tij [edhe] të gjithë ju që e druani - të vegjël e të mëdhenj! Ndërkaq dëgjova, si zërin e një shumice të madhe njerëzish, si ushtimën e ujërave të mëdha, bubullimë rrufesh të forta: Aleluja! Mbretëroi Zoti, Hyji [ynë], i gjithëpushtetshmi.

Aleluja, e cila del me këtë tejshkrim në gjuhën shqipe, sipas parimit fonetik, rrjedh nga hebraishtja, gjuha e Dhiatës së Vjetër, הַלְלוּ יְהוָה

(hallelu-Jah). Zbërthimi i saj zbulon, së pari, foljen hallal, e cila është në vetën e dytë shumëse të mënyrës urdhërore dhe ka kuptimin “lëvdoni.” Pjesa e dytë, Jah, e cila është shkurtesë e emrit hebraik të Hyjit, JHVH (יהוה). Prandaj, përkthyer fjalë për fjalë, aleluja, do të thotë “lëvdoni Hyjin.” Aleluja është klithje, zë, ose britmë nderimi drejtuar Hyjit, e cila e madhëron, e lavdëron dhe e lartëson.

Në liturgjinë e krishterë Aleluja është edhe emri i një kënge që shërben si brohoritje drejtuar Krishtit të Ngjallur, Fituesit mbi vdekjen dhe



mëkatit, i cili me fjalën e vet është i pranishëm në bashkësinë e besimtarëve. Kjo klithje e gëzimit, Alelujae kënduar, krijon mjedis përshpirtërie, në të cilën Zotëria vjen përmes fjalës së Ungjillit.

Gjatë Shërbesës së Fjalës në kremtimin e Meshës, Aleluja këndohet para leximit të Ungjillit. Kurrë nuk duhet të recitohet në mënyrë të thjeshtë, d.m.th., pa u kënduar, sepse është brohoritje solemne dhe madhështore. Aleluja e pakënduar mendohet të jetë kundërshti në

vetvete. Gjykuar sipas këtij mendimi mund të themi: Aleluja e kënduar është një fanfarë, bori, dhe trumbetë që i bën me dije të pranishmit se Krishti tanimë do t'u flasë me fjalën e vet.

Aleluja këndohet me melodi të ndryshme nga i tërë populli dhe gjatë tërë vitit kishtar, përpos në Kohën e Kreshmëve kur zëvendësohet me një "traktus" (kështu quhej më parë) ose (sipas terminologjisë së tashme) "Brohoritja (thirrja) para Ungjillit", p.sh.: "Lavdi Ty, o Krisht, Mbreti i lavdisë së amshuar!" Pashkët janë festa në të cilën, pas "njinesës" edhe me Alelujën, me madhëstsinë më të madhe ajo do të këndohet përsëri. Ndryshe, Aleluja ose vargu para Ungjillit mund të hiqet nëse nuk këndohet.

Kjo brohoritje "është një rit ose veprim në vete, me anë të të cilit bashkësia e besimtarëve mirëpret dhe përshëndet Zotërinë, i cili ka për t'i folur asaj në Ungjill, dhe shpall fenë e saj me anë të këngës. Ajo këndohet prej të gjithëve në këmbë dhe udhëhiqet nga kori ose kënduesi, duke u përsëritur po qe se kjo është me vend" (Rregullorja 62 në Meshari Romak, botimi tipik i tretë, Romë 2002). Aleluja ka edhe një varg, i cili duhet të këndohet ose nga kori, ose nga kënduesi a këngëtori. Vargu që këndohet a ligjërohet nga lexuesi, por edhe nga prifti që do të lexojë Ungjillin, rëndom merret nga Ungjilli ose përkon me Fjalën e Zotit.

Ngritja në këmbë për ta kënduar Alelujën ka rëndësi të veçantë. Mund të themi që kjo ngritje, ndenja gatitu në këmbë duke brohoritur Alelujën, e përforcon edhe më shumë mendimin, të shprehur nga shumë liturgjistë, që Mesha është teatër i shenjtë. Vetë kjo brohori, kjo klithje, Lëvdoni Zotin, e bën tejet gjallëruese e dramatike Shërbesën e Fjalës. Guxojmë edhe të shtojmë: Shërbesa e Fjalës shndërrohet në dramaturgjë dhe të gjithë të pranishmit shndërrohen në aktorë të shenjtë, që para se të kenë dëgjuar Fjalën e Ungjillit, lajmin e gëzimit të përhershëm të Krishtit, e lartësojnë, lëvdojnë, madhërojnë, përhimnojnë dhe i thurin lavde vetë Atij.

Aleluja këndohet edhe në Kishat e tjera të krishtera para Ungjillit, si p.sh. në bashkësitë karizmatike-pentekostale, në liturgjinë e Kishës Ungjillore, në ritet e Kishës Lindore, si dhe në Kishën Ortodokse gjatë tërë vitit pa përjashtime dhe shumë herë në Liturgjinë Hyjnore.

Studimet liturgjike bëjnë të ditur se Aleluja qe kënduar edhe jashtë liturgjisë së Meshës, edhe në vetë kohën kur filluan melizmat (rrokje të

fundme shumë të pasura melodike që mbarojnë me "a" te Aleluja, dhe me "e" te Kyrie ; zbukurime melodike, fioriturë dhe koloraturë; te këndimi melizmatik shumë nota bien mbi një vokal a rrokje, për dallim nga këndimi silabik, ku mbi çdo rrokje vjen një zë). Pra nga Aleluja ka rrjedhur edhe ndjekësorja (sekuenca). Ndjekësorja zakonisht këndohet para Alelujës. Fillimisht kuptohej si melodi pa fjalë mbi "a"-në fundore të alelujës, të quajtur "jubilus". (Jubilus, shumës jubili) është termi për melizmën e gjatë që vendoset në rrokjen e fundit të Alelujës sipas mënyrës gregoriane të këndimit të saj. Struktura e Alelujës është e tillë që kënduesi së pari këndon fjalën "aleluja" pa jubilus, dhe pastaj kori e përsërit fjalën duke e shtuar melizmën. Tradicionalisht ai përsëritet edhe në fund të këngës, ndonëse ai shpesh lihej jashtë në Mesjetë, dhe ende lihet jashtë kur Alelujën e ndjek sekuenca a ndjekësorja). Për Shën Augustinin jubilus (teksti pa fjalë) "është shprehje e zemrës, të cilën fjala nuk mundet ta përfshijë". Më vonë kësaj melodie i qe shtuar një tekst në prozë, me një rrokje për secilën notë. Kur u pajisën me fjalë, ndjekësore të tilla kishin për qëllim përshëndetjen dhe nderimin e Krishtit që është i pranishëm në Ungjill. Më vonë, kur përmendej "sekuenca", mendohej për një strukturë të ndërlikuar. Si përfundim të këtij zhvillimi, ndjekësoret (sekuencat) u kanë përngjarë himneve.

Gjatë shekujve qenë krijuar qindra ndjekësoresh që u futën në përshpirtërinë popullore. Por për të ruajtur Kishën nga ndikimet e herezive dhe për shkak të mangësive teologjike në përmbajtjet e tyre, Koncili i Tridentit (1545–1563) pati kufizuar përdorimin e tyre. Meshari i vitit 1570 njeh vetëm katër sosh: Victimae paschali laudes (shek. 11) për Pashkët e Ngjalljes; Veni Sancte Spiritus (shek. 12/13) për Pesëdhjetoren (Rrëshajën); Lauda Sion Salvatorem, të shkruar nga Shën Toma i Akuinit me porosinë e Papës për festën e Korpit dhe Gjakut të Krishtit; dhe Dies Irae (në Requiëm, në Meshat për të vdekurit). Në Mesharin e vitit 1970 qe shtuar edhe ndjekësorja mariane: Stabat Mater për festën Shtatë Dhimbjet e Marisë (15 shtator). Sot, Meshari i tanishëm parasheh ndjekësoren e Pashkëve dhe të Pesëdhjetores, por lejon edhe përdorimin e ndjekësoreve të Korpit dhe Gjakut të Krishtit dhe Dhembjeve të Shën Marisë.

Dr. Kastriot MARKU
Milano - Itali

KONÇILI I TRETË SHQIPTAR
Concilium Albanum Tertium (1895)
Me rastin e 120 vjetorit

Shkodër, 19 maj- 23 qershor 1895.

Aktet e Kuvendeve kishtare shqiptare janë dëshmi e fortë e latinitetit evropian të kishës katolike në Shqipëri si dhe mbrojtjes së identitetit kombëtar të shqiptarëve. Këto kuvende kishtare, aktet e të cilave janë mbajtur latinisht, (përjashtoj ato të kuvendit të Matit në shekullin e XV (1462), të cilat kanë ardhur në gjendje dorëshkrimore), të tjerat mbajtur përkatësisht një një në shekullin e XVIII (1703), si dhe dy në shekullin e XIX (1871 dhe 1895), aktet e tyre i kanë botuar. Kësaj radhe po ndalemi në Konçilin III Shqiptar (1895), i cili këtë vit (maj-qershor), shënon 120-vjetorin e mbajtjes së tij.

Në vijim të dekreteve dhe udhëzimeve, pra dispozitave të Konçilit II shqiptar të mbajtur në vitin 1871, nga data 19 maj 1895 deri më 23 qershor 1895, u mbajt në Katedralen e Shkodrës Konçili i Tretë Shqiptar. Qëllimi i këtij konçili ishte ringjallja e katolicizmit në provincat kishtare shqiptare në mënyrë që aktiviteti misionar të kishte efektet e duhura. Kongregata e Shenjtë e Përhapjes së Fesë, (lat. *Sacrae Congregationis de Propaganda Fide*, ital. *Sacra Congregazione de Propaganda Fide*), që një vit më parë kishte lëshuar dekretin përkatës në të cilin ftoheshin arqipeshkvinjtë dhe ipeshkvinjtë e Shqipërisë për t'u mbledhur në një koncil kombëtar. Në vitin 1897, dy vjet pas mbajtjes së tij, materialet e këtij Konçili u publikuan në gjuhën latinë nga Shtypshkronja e Kongregatës së Propagandës Fide me titullin: *Concilium Albanum Tertium Provinciale sive Nationale habitum anno MDCCCXCV Leone XIII Pontifice Maximo, Romae ex Typographia Polyglotta S. C. De Propaganda Fide 1897. 60 pp.* Nga shfletimi i këtyre materialeve krijohet një pamje mjaft e qartë rreth punimeve dhe përmbajtjes së vendimeve të marra në funksion të veprimtarisë së Kishës në dioqezat shqiptare. Fjalën hyrëse në koncil e mbajti Delegati Apostolik dhe njëherazi Kryepeshkvi i Shkodrës Imzot Pashk Guerini, në të cilën ai theksoi



përparimet që kishte bërë Kisha Katolike gjatë periudhës pas Konçilit të Dytë Kombëtar, sa i takon hapjes së shkollave fetare, seminarit dhe në rrëfimin e hapur të fesë së krishterë.

Përmbledhja e akteve konçiliar

Përmbledhje e akteve konçiliara hapet me dekretin miratues të këtyre akteve dhënë në Romë më 30 korrik 1897 nga Prefekti i Propagandës Fide, Kardinal **Mieczysław Halka Ledóchowski** (29.10.1822-22 korrik 1902). (f. 3-4). Më pas vijon letra e Arqipeshkvit të Shkodrës Imzot Pashk Guerini, (Shih: Litterae. Indictionis Concilii Provincialis sive nationalis, (f. 5-7), i cili në cilësinë e Delegatit Apostolik, me 19 mars 1895, ditën e Shën Jozefit, dy muaj para mbajtjes së Konçilit, njoftonte përmes saj arqipeshkvinjtë dhe ipeshkvinjtë e dioqezave shqiptare për mbajtjen e Konçilit në Shkodër të dielën e pestë pas Pashkëve, më 19 maj 1895, nën projën e Shën Jozefit. Prelatët kishtarë duhej të ishin të pranishëm detyrimisht, përjashtoj rastet e justifikuara për arsye kanonike, sepse mbajtja e këtij konçili ishte propozuar nga Kongregata e Propagandës Fide, dhe ishte aprovuar nga Shenjtëria e Tij Papa Leoni XII, fillimisht në një audiencë të mbajtur më datën 8 prill 1894, për t'u zyrtarizuar me dekretin përkatës të datës 23 prill 1894. Po ashtu në hyrje të seancës së parë të Konçilit në fjalën e tij Imzot Guerini kujtoi rëndësinë e shkollimit ku një vend me rëndësi zinte Kolegji Papnor në të cilin zhvilloheshin studimet teologjike duke shprehur kënaqësinë me këtë rast për rritjen e

numrit të studentëve si dhe veprimtarinë e denjë të shoqërive të përshtirshme të të Tretit Urdhën të Shën Françeskut, të Zojës Nunciatë, të Zojës Rruzare etj. Po ashtu ai vë në dukje punën e mirë të bërë nga “misioni fluturues” i formuar nga Kongregata e Shenjtë e Propagandës Fide, Noviciatet e Françeskanëve të Reformuar në Durrës e Prizren, hapjen e disa shtëpive për edukimin e vajzave nga ana e motrave françeskane si dhe kuvendeve të novicëve të fretërve observantë në Kallmet në dioqezën e Lezhës dhe në Troshan në Ipeshkvinë e Sapës.

PJESA E PARË (f. 15-30) e përmbledhjes së akteve të Konçilit ndahet në nëntë kapituj dhe kapitulli i tetë i kësaj pjese ka pesë nënkaptuj. Në hyrje kemi profesionin/dëshminë e fesë sipas Besojmës etërit dëshmojnë të pranuar publikisht të vërtetat e shpallura nga të gjithë konçilet ekumenike, në mënyrë të veçantë ato të Konçilit të Trentit dhe ato të Konçili I të Vatikanit, mohimin e herezive, pranimin e Shkrimit të Shenjtë, shtatë sakramenteve, flinë e meshës, nderimin e Krishtit dhe Zojës së Bekuar, pranimin e Kishës Katolike apostolike romane, dëgjuesin ndaj autoritetit të Papës si pasardhës i Shën Pjetrit dhe zëvendës i Krishtit në tokë. Kapitulli i dytë vijohet me rikonfirmimin dhe përtëritjen e dekreteve të Konçilit II shqiptar dhe në kapitullin e tretë besimtarët katolikë shqiptarë duhet të dëshmojnë fenë e tyre duke u ruajtur nga infektimi me besimin islam dhe në mënyrë të veçantë detyrohen kriptokatolikët/laramanët ta shpallin haptas publikisht para besimtarëve dhe popullit fenë e tyre. Kapitulli i katërt vlerëson aktet e Selisë së Shenjtë, sidomos ato të Papës Leoni XIII ndërsa kapitulli i pestë jep udhëzime se çfarë duhet të mësojnë besimtarët e krishterë për doktrinën e krishterë bazuar në mësimin e fëmijëve dhe të rriturve në fe kryesisht përmes mbajtjes së të Shenjtërueshmit Sakrament, lutjes së rruzares së Zojës. Konçili urdhëron famullitarët që fëmijët para se të marrin kungimin e parë të kenë bërë një përgatitje paraprake dhe për këtë të përdoret katekizmi i A. Ferrarit, përkthyer nga italishtja nga Ndre Logorezi, botim i vitt 1886 nga Propaganda Fide. Në kapitullin e gjashtë i jepet rëndësi predikimit të fjalës së Zotit nga ana e meshtarëve dhe këshillohet devocioni në nder të Zojës së Bekuar në muajin Maj. Në kapitullin e shtatë trajtohen festat dhe festimet ku nënvizohet se nuk duhet të punohet ditët e festave dhe të dielave dhe besimtarët të marrin pjesë çdo të dielë në meshte të gjithë, veçanërisht gratë dhe vajzat. Kapitulli i tetë trajton veset e këqija në pesë nënkaptuj si vrasjet, vjedhjet, benë rrenë, kamatat dhe bestynitë. Në mënyrë të veçantë urdhërohet që të predikohet lidhur me vrasjen nga ana e meshtarëve veçanërisht për Këshndella, Pashkë e Rrëshajë për këtë të keqe të

madhe e të rëndë duke e dënuar këtë krim të rëndë si dhe të dënohen publikisht vrasësit dhe ata që i ndihmojnë këta të fundit si dhe t'u ndalohet atyre dhënia e sakramenteve, ndërkohë hajdutëve u ndalohet varrimi kishtar, ndërsa ata që pendohen e rrëfihen duhet të kthejnë gjërat e vjedhura dhe të premtojnë se nuk do të përsërisin këtë gjë, i mësohet heqjes dorë nga betimi, ndalohen fajdet/kamatat që kalojnë mbi 10 % si dhe ndalohen bestynitë përmes të cilave fyhet Zoti. Kapitulli i nëntë dhe i fundit i kësaj pjese të parë i kushtohet përshtirësisë ndaj Zembrës së Krishtit, Familjes së Shenjtë dhe Zojës së Bekuar. Vlen të theksohet se përcaktohet respektimi i dëshirës së Papës Leoni XII që e diela e tretë pas Ujit të Bekuar të festohet në mënyrë solemne me meshë dhe me lutje në nderim të Familjes ndërkohë caktohet zyrtarisht Zoja e Këshillit të Mirë (26 prill) si Pajtores e popullit shqiptar.

PJESA E DYTË (f. 31-40), ndahet në shtatë kapituj në të cilët trajtohet administrimi i sakramenteve. Në kapitullin e parë për pagëzimin porositen famullitarët që t'a administrojnë me kujdes pagëzimin duke mos pranuar prerjen e flokëve dhe pirjen e disa pikave të gjakut në kundërshtim me mësimet e Kishës. Pagëzimi duhet të bëhet vetëm me paraninë e kumbarëës, të kujdesohen famullitarët për burimin pagëzimor si dhe të ndalohen dhuratat. Sa i takon rrëfimit në kapitullin e dytë, ndalohet rrëfimi në shtëpi, përveç në rast sëmundje dhe kishat të kenë rrëfyshore, ndërsa sa i takon eukaristisë në kapitullin e tretë kërkohet ruajtja e të Shenjtërueshmit sacrament, teksa në kapitullin e katërt këshillohen famullitarët të mënjanohej sa është e mundur paragjykimi sa i takon vajimit dhe të mos vdesë kush pa e pranuar atë. Në kapitullin e pestë etërit konstatojnë praktikimin e rregullores së Konçilit të Trentit, rendin e Ritualit Romak dhe akteve të tjera të Selisë së Shenjtë dhe konçileve kombëtare të mëparshme. U kritikua fejesa në moshë të re për vajzat të cilët prindërit i shesin kur rriten duke i detyruar të martohen pa pëlqimin dhe kundër vullnetit të tyre si dhe në kapitullin e gjashtë konçili vendos që të mos u jepen sakramentet atyre që mbajnë gra pa kurorë apo pas lëshimit të gruas legjitime mbajnë një grua tjetër. Kapitulli i shtatë i kushtohet virgjërave të cilave pasi u verifikohet qëllimi dhe dëshira e tyre u porositet të drejtohen në një institut si Shoqëria e Bijave të Marisë, u caktohet një veshje e posaçme dhe edukohen në një jetë shembullore. Nuk u lejohet të vishen si burrat.

PJESA E TRETË (f. 41-47), ka pesë kapituj, prej të cilëve kapitulli i pestë ka edhe ai tre nënkaptuj. Në kapitullin e parë trajtohet roli dhe detyrat e ipeshkvinjve të cilët tre muaj pas përfundimit të konçilit të mbajnë sinodet në dioqezat përkatëse në të

cilët duhet të marrin pjesë të gjithë meshtarët, TË KUJDESOHEN për hapjen e shkollave fillore dhe instituteve fetare në mënyrë që të rinjtë e të rejtat të formohen sa më mirë. Në kapitullin e dytë trajtohen kisha dhe pronat e saj të tundshme dhe të patundshme dhe inventari i pajisjeve kishtarë për të cilët famulltarët duhet të bëjnë kujdes të madh. Në kapitullin e tretë që flet për Altarin dhe Meshën e Shenjtë, thuhet se altaret duhen të mirëmbahen pastër në mënyrë të denjë për një shërbim të tillë dhe të ndalohej mesha në shtëpi, përveç në rastet nevojash për kungimimn e të sëmurëve. Në kapitullin e katërt kërkohet që varrezat të jenë të rrethuara në mënyrë që të mos profanohen. Kapitulli i pestë i kushton vëmendje Kolegji Papnor Shqiptar, i cili falë ndihmës së dhënë nga Kongregata e Propagandës Fide dhe qeveria austro-hungareze, shërben për të gjitha dioqezat, ngaqë sipas Konçilit të Trentit nuk ishte e mundur të kishte seminar për çdo dioqezë, dhe për këtë ai u është besuar etërve jezuitë. Gjithashtu bazuar në kërkesat në rritje të thirrjeve kërkohet që të hapen noviciatet në Shkodër dhe në Troshan. Po ashtu kërkohet që shoqëritë shpirtërore si: I treti Urdhër i Shën Françeskut, Shoqëria e Zojës së Papërlyer e jezuitëve, Shoqëria e Zojës Rruzare, Shoqëria e Zojës Nunciatë në Prizren të vijonë veprimtarinë e tyre shembullore të përshpirtmërisë dhe të shtohet numri i tyre.

PJESA E KATËRT (f. 48-58), ka tre kapituj në të cilët trajtohen famulltarët, të mirat materiale dhe etërit misionarë e meshtarët. Në kapitullin e parë meshtarëve u kërkohet që të plotësojnë detyrat e tyre pastorale duke qëndruar vazhdimisht në famulli dhe duke u larguar vetëm me leje me shkrim nga ipeshkvi, të kujdesohen për të sëmurat, varrimin, për rrëfimin, të bëjnë kujdes për librat liturgjikë, si dhe të shënojnë pagëzimet, krezmimet, kurorat, vdekjet dhe mbi bazën e tyre të hartohen statistikat e famullisë. Shërbimi meshtarak duhet të kryhet në shtëpi vetëm për personat e sëmurë. Në kapitullin e dytë meshtarëve u kërkohet kujdes për administrimin e të mirave materiale në mënyrë që ato të ruhen dhe të mos tjetërsohen e për të cilat gjithnjë duhet të vihet në dijeni ipeshkvi. Kapitulli i tretë dhe i fundit të kësaj pjese dhe i gjithë konçilit i kushton vëmendje etërve misionarë të cilat të veprojnë në pajtim me rregullin e urdhërit të tyre në dioqezat përkatëse sipas udhëzimeve të dhëna nga Propaganda Fide dhe u lihen atyre famullitë e Gomsiqes dhe të Iballës. Konçili



mbyllet me një lutje drejtuar Shenjtërisë së Tij Papës që t'i konformijë vendimet e marra për t'u përmbyllur me nënshkrimin e pjesmarrësve në Konçil si dhe fjalën përmbyllëse të arqipeshkvit të Shkodrës.

Pjesëmarrësit e Konçilit:

Pjesëmarrësit që firmosën më 29.VI. 1895, në Koncilin III Shqiptar, bajtur në Kishën Katedralë, Metropolitane të Shkodrës, nën kryesinë e Imzot Pashko Guerinit. Imzot Pashk Guerini, arqipeshkëv i Shkodrës, Delegat Apostolik dhe Kryetar i Konçilit. Imzot Pashk Trokshi, arqipeshkëv i Shkupit. Imzot Prend Bardhi (Bianchi), arqipeshkëv i Durrësit.

Imzot Fra Jul Marsili, ipeshkëv titullar i Antigonës.
Imzot Fra Nikollë Marconi, ipeshkëv i Pultit.
Imzot Fra Gabriel Neviani, ipeshkëv i Sapës.
Imzot Prengë Doçi, abat i Shën Llezhdrit të Mirditës.
Imzot Nikollë Shtufi, komisar nderi i Shkëlqësisë së Tij Papa Luani XIII, famullitar i Kallmetit dhe Prokurator i Ipeshkvit të Lezhës.
Atë Fra Pjetri nga Senogallia, Preprefekt Apostolik i Misioneve të Pultit.
Atë Fra Luigji nga Coriano, Preprefekt Apostolik i Misioneve të Kastratit.
Atë Fra Pjetri nga Virolavetei, Epror i Misioneve të Serbisë.
Atë Fra Deda (Dominicus) nga Bari, Epror i Misioneve të Maqedonisë.
Atë Fra Toma nga Rapino, Komisar i Përgjithshëm i Misioneve të Epirit.
Imzot Pashko Babi, Kapelan Nderi i Shkëlqësisë së Tij Papa Luani XIII e famullitar i Jubanit, në emër të klerit të Arkidioqezës së Shkodrës.
Imzot Shtjefën Krasniqi, Komisar nderi i Shkëlqësisë së Tij Papa Luani XIII, meshtar i arqipeshkvisë së Shkupit, në emër të klerit të Arkidioqezës së Shkupit.
Dom Nikollë Kaçorri, famullitar i Durrësit, në emër të klerit të Arkidioqezës.
Dom Lazër Mjeda, famullitar i Planit në emër të klerit të Dioqezës së Pultit.
Dom Jak Bushati, famullitar i Hajmelit në emër të klerit të dioqezës së Sapës.
Dom Dedë Koleci, famullitar i Mnelës në emër të klerit të abacisë së Shën Aleksandrit të Mirditës.
Dom Nikollë Gojani, ndihmës famullitar i Shkodrës, Sekretar i Konçilit.
Dom Ndue (Anton) Mjeda, meshtar i arkidioqezit të Shkodrës, Noter i Konçilit.

Ledi Shamku-Shkreli
Tiranë

SHTJEFËN GJEÇOVI THEMELUES I ETNOGRAFIË SHQIPE Janjevë 1874 – Zymb 1929

Fjala është si uji i tokës, ujë që ka gjithë shijen e shkëmbit prej të cilit rrjedh po edhe të truallit përmes të cilit kalon e shpërndahet.

Në lumin e një gjuhe çojnë ujë shumë degëzim e përrënsh, rrë-kesh e shehesh. Njëri syresh është ai ku derdhen mitet, legjendat e rrëfenjat. Dhe në këtë hulli, prej At Shtjefën Gjeçovit trashë-gojmë njëmend plotën më të çmuar, pasi ajo ka gjarpëruar nëpër të gjitha viset tona, nga jugu në veri, nga mali në fushë, e kqyrur besnikisht prej tij.

Ndryshe nga kulturat rrotull nesh, të cilat janë bija traditash që njohën shkrimin dhe vijuan gjithnjë të shkruajnë, kjo jona nuk u shkrua në ag të kohëve e mandej, për ndeshtrashat e historisë, u shkrua teevona dhe shkrimet qenë të pakta. Kultura gojore e dëshmuar përmes miteve, legjendave, dokeve e rrëfenjave është edhe kripta e ngrehinës sonë etnokulturore.

Nuk është krejt e errët falë dritave dëshmitare si ajo e At Shtjefën Gjeçovit, porse i duhet rënë pas me kqyrje edhe më të imëta, duke shfrytëzuar zhvillimin e gjuhësisë në këtë qindvjetësh. Tekembrama qysh nga shkolla filologjike e Max Müllerit e kënde, mitet, e sidomos mitet indoeuropiane, konsiderohen magmë gjuhësore, studimi i tyre është pjesë e gjuhësisë së krahasuar, pasi janë në thelb përshkrime poetike të përshfaqjeve të natyrës, zotat s'janë gjë tjetër veçse të mistershmet dukuri natyrore dhe emrat e zotave lindin si epitete të këtyre dukurive.

E kështu, përmes etimologjisë dhe krahasimit, gjenden dhe shpjegohen këto



emra që janë fjalë, duke shpjeguar kështoj përmes pranëvënies së fjalëve-epitete edhe marrëdhëniet mes gjuhëve e gjindjes që i ka folur.

Ky është edhe ekskursi i etnolinguistikës: studimi dhe interpretimi i çdo shfaqjeje gjuhësore në lidhje të ngushtë me kulturën që e ka prodhuar, veçse e gjitha kjo në kuadrin e kategorive me vlerë universale.

Le t'i kthehemi një gojëdhane të dëshmuar nga Gjeçovi tek "Trashëgime Thrako-Ilirjane": "Shkaf asht emen hyjnijet qi së vonit u

vedituen prej kombesh te kanteve të dheut, i mueren prej Pellazgjësh a se prej atynve njerzve t'egjer e bjeshkana, njerzve gavej a vigaj qi në gjuhë t'onë edhe sot thirren 'Katallaj' e qi ishin me një sy në ball si thotë Omeri (Kiklopes); njerëz qi quheshin farktorët e Rrëfeve të Jovit si e dishmon Hesiodi. Zoja Kjiuro nga Palavlija (vend pranë Delvinës), kishte pasë rrëfye ket gojëdhanë mbi Hyun: Zoti kishte pasë lufët me Gegët, (se Gegët quheshin Qeravnarët a Titanët e të afërmit e tyne Antititant) edhe Zoti kishte ndimëtarë njerëz me një sy (Kiklopët-



Katallajët). Kjo luftë ngjati dhetë vjet. Shkaktarët e luftës kjen Titanët (Gegët) të cilët deshten me shthronëzue Zotin e në Kambë të ti me kunorue për mret Martin, pse ishte trim edhe i pashëm. Në ket luftë Zoti doli ngadhnjyes; i vuni perpara Gegët edhe i qiti tej lumin e Vjosës e në vend të tyne solli Lapthit (Labët). Në ket luftë muerën pjesë të gjith trimat mbretnorë (të gjith perendijt pra). Gegët të muejtun u zhgulen, e në vend të tyne mbretnoj Zoti, vëllazent e ti e fëmijet e ti”.

E bukur kjo gojëdhanë që e vendos luftën e Kryezotit pranë lumit të Vjosës sonë, e sheh atë si luftë mes Gegëve dhe Labve, pikërisht aty ku edhe kalon kufiri i leberve me pjesën tjetër pra edhe me gegët e sotëm. E bukur edhe dëshmia shqiptare për luftën mes Jovit e Marsit, pasi gjejmë përkim të kësaj gojëdhanë në studimin e Andre Martinet “Gli indoeuropei. Lingue, popoli e culture”, në të cilin autori dëshmon se për indouropianët e parë ndeshja kryesore ka qenë mes Kryezotit që i kishte të dyja fuqitë e zjarrit, edhe të mirën edhe të keqen dhe Zotit të Luftës (Martit në gojëdhanën tonë), i cili fuqinë e zjarrit e përdorte vetëm për të shkrumbuar.

Dhe po sipas Martinet-së kjo luftë zgjati derisa Kryezoti i indoeuropianëve e “ndau” pushtetin në dy Zota: në Zotin e Dritës i cili ngrohte dhe në Zotin e Luftës i cili shkrumbonte (Marsi për latinët, Thori për gjermanikët, Odini më pas për skandinavët e kështu me radhë). E po ashtu edhe në mitologjinë greke, Titanët (të cilët në gojëdhanën tonë janë Gegët) dallojnë nga Gjigandët, të cilët sipas Hesiodit shkaktuan atë që njihet si Gigantomachia apo lufta kundër zotave të Olimp. Dhe jemi brenda së njëjtës rrëfenjë si ajo e mbledhur në Palavli, porse me kah të kundërt luftimi.

Po le ta ndjekim edhe pas Gjeçovit këtë figurën e ushtarëve të Zotit, a siç e dëshmon ai me gojëdhanën e vet, të Katallajve me një sy.

Si u shestuan figura në folklorin tonë!

Çabej shkruan se “një vëmendje të veçantë meriton ai divi vigan e me një sy në ballë, që del shpesh nëpër përrallat e shqiptarëve, të serbëve, të morlakëve e të së tjerëve popuj të Ballkanit po edhe në vise të tjera të Europës gjer lart në Finlandë. Është figura e atij kiklopi që ha njerëz, sikurse na shfaqet që te Odiseja e Homerit me emrin Polifem (...). Është për të vënë re që kjo figurë në shekullin e kaluar ishte gjallë edhe tek

elementi arbëresh i Siqelisë, sikurse shihet nga një mbledhje e gjuhëtarit italian D. Compareti. Sikurse e vuri re G. Meyeri, tek emri i këtij divi të egër ruhet kujtimi i kompanisë së mercenarëve nga Katalanja e Spanjës, të cilët hynë më parë (më 1302) në shërbim të perandorit bizantin Andronik II Paleologut e më pas, si kusarë deti, ranë pre për disa kohë nëpër Gadishull të Ballkanit. Ky gjigand në Shqipëri përfytyrohet si një farkëtar div i palatuar, me një sy në ballë, pa gjunjë e me këmbë të drejta si dyrek. Po të sillemi nga jugu i Shqipërisë do të shohim se kjo figurë divi e cila na del sidomos në Labëri (kujtojmë edhe gojëdhanën e Gjeçovit këtu – shën. imi), mban një emër vendi e quhet Siqënhenjeri. Ky emër që në formimin e vet është një bashkim dy kompozitësh, me kuptimin “syqen” që ha njerëz”, paraqet interes edhe për folklorin”. Le ta shohim shpërndarjen e kësaj figure mitologjike përsëpari në traditat folklorike rrotull nesh. Ky lloj qiklopi te bullgarët quhet “ednook” (me një sy), ndërsa te rumunët thirret “ochila” dhe lidhet poashtu me syun. Të njëjtat veçanti demonologjike ka edhe kensa që në përrallat serbe e kroate thirret “psoglavi, pasoglavci” e që



don me thënë “kryeqen, kokëqen”. Si-kundër vëren Çabej, këto figura Cajkanoviçi “objektivisht e gjuhësisht i afron me greqishten ‘kunokefaloj’ dhe sheh aty një kryqëzim figurash të besimeve orientale me demonët kufomëngrënës të disa popujve indoeuropianë”.

Këtij vargu krahasimesh mund t’i shtojmë edhe apelativin bullgar “pesoglaveca” dhe atë rumun “capcaun”, që duan të thonë poashtu “kryeqen” dhe dalin si demonë që hanë mish njeriu. Vijon Çabej: “Është afërmendsh të mendohet në këtë mes që këto emra të gjuhëve sllave e të rumanishtes të jenë të jenë përkthime (calques linguistiques) të greqishtes “kunokefaloj”, si reflekse të ndikimit bizantin në ato gjuhë.

Përsa i përket Syqenit e Syqenëzës së shqipes, këto, si figura, për vetinë antropofage që kanë, hyjnë pas gjithë gjasash edhe këto në këtë grup demonësh.

Nga pikëpamja e formimit gjuhësor ndërkaq këto largohen nga figurat në fjalë të popujve fqinj sepse janë emërtuar nga një krahasim me sytë e jo me kokën e qenit”. Mëtojmë ta shtyjme

mendimin, duke parë të shkrirë në një disa veti kensash që i përgjigjen të njëjtës figurë demoniake: syun e vetëm si tipar të cilin e vëmë re te Katallajtë (Kiklopes) me qenin që ha njerëz më anë tjetër.

I do mëshuar faktit se gjetje të tilla në kulturat vernakulare janë tejet të rëndësishme, pasi ato nuk janë thjesht elemente përrallash.

Sikundër vëren Max Müller, në kohët e lashta, figura të tilla të teogonisë ishin qeverisja e jetës së përditshme, e mandej me kalimin e njerëzimit nga besimi politeist në atë monoteist, ato u bënë thjesht pjesë e folklorit në trajtë përrallash e legjendash.

Si u shestuan këto figura në folklorin tonë dhe në atë rrotull nesh, le të vërejmë çfarë shkruhet në burimet historike mbi apelativët e lartpërmendur.

Izidori i Siviljes (560-636 pas Krishtit), në vëllimin e tij Etimologie XI, 3 shkruan: “Sikundër mes njerëzve vërehen edhe individë të deformuar, ashtu edhe brenda farës njerëzore të vëzhguar në tërësinë e vet, ekzistojnë fise të përbëra nga përbindësja, sikundër janë



Gjigandët, Cinoqefalët (Kokëqentë), Qiklopët dhe të tjerë të ngjashëm”. Edhe për Strabonin dhe Plin Plakun ekzistonin popuj të tillë, të thirrur Cynamolgi dhe banonin në Etiopi, ndërsa tek Tertuliani dalin si Cynopennae dhe ai i vendos në Persi. Kryeqentë vijnë të dalin edhe në historiografinë mesjetare.

Kleriku Hyon de Narbonne, në një letër dërguar arqipeshkvit të Bordosë, Gerardus de Malemort, përshkruan rrethimin që i bënë tartarët qytezës Wiener Neustadt.

Dhe kur flet mbi mizoritë e tartarëve, ai thotë se prijësat e tyre kanë Cinoqefalë (Kryeqenë) në radhët e veta, të cilëve u japin të hanë trupat e robërve të luftës.

Figura e Kryeqenit, mesa duket tejet e ngulët në besimin e popujve, mbërrin të kapërcejë edhe në hagjiografinë e krishterë.

Në mjaft ikona e afreske bizantine, Shën Kristofori paraqitet me shembëlltyrën e një Cinoqefali (Kryeqeni).

E po ashtu në Passio sancti Christophori martyris, tekst i cili pati një përhapje të madhe në Mesjetë, Shën Kristofori përshkruhet si një gjigand i llojit të Kryeqenve, i cili u konvertua pasi barti me mundim mbi supë Krishtin fëmijë

nga njëra anë e lumit në tjetrën.

Pas vëzhgimesh të tilla, bëhet edhe më e qartë pse rrëfenjat me Qiklopë e Katallaj kanë mbërritë të patrazuara deri në kohë të Gjeçovit, e sidomos bëhet edhe më i domosdoshëm rishqyrtimi i krejt trashëgimisë së tij mitologjike duke e krahasuar me arealin ku kultura jonë bën pjesë.

Këtu u ndalëm vetëm në njërën nga thërmijat e “Trashëgime Thrako-Ilirjane” të Gjeçovit, porse korpusi i tij përmban shumë mbledhje të këtilla, të shestuara si pikë-premje mes mitit dhe historisë.

Gjejmë aty përralla, doke e zakone të lashta të gjindjes sonë, përshkrime të kostumografisë popullore, të tatuazheve për të cilat shtyhet thellë-thellë në kohë, gjejmë përshkrime të betimeve mbi gur e mbi rrufe, ligje e mënyra caktimi kufijsh e trojesh, nderimin e malësorëve tanë ndaj Diellit duke bërë kryq në ballë e gjithë çka janë rregullat e jetës zakonore të një populli që beson në Zot e ruan traditat.

Ky korpus e bën Gjeçovin themeluesin e Etnografisë Shqiptare. Ky korpus i rishqyrtuar është edhe elementi integruar i kulturës sonë kombëtare.



Iliriana Koleka
Tiranë

KONGRESI I PARË I MANASTIRIT (14-22 NËNTOR 1908)

(Pjesa e dytë)

Kongresi i parë i Manastirit (apo Kongresi i Alfabetit) është tubimi i dijetarëve shqiptarë më 14 - 22 nëntor 1908, në Manastir, për përcaktimin e alfabetit të gjuhës shqipe.

Kongresi i Manastirit - rruga drejt bashkimit kombëtar

Veprimtaria kombëtare, ose më konkretisht, ajo kulturo-arsimore dhe gjithë proceset që shkojnë në favor të çështjes kombëtare, kanë pasur momente kur janë lartësuar, kanë qenë të çmuara dhe të domosdoshme për kohën dhe ishin të krijuara, dhe, ka pasur momente kur kanë pasur rënie, rënie jo nga vetë koha, por rënie me qëllim për të humbur ose ndaluar realizimin e idealeve.

Në periudhën para 1908, dimë se në çfarë kushtesh kanë punuar atdhetarët tanë, sidomos ata që merreshin me veprimtari letrare ose kulturore. Duke marrë parasysh se territori shqiptar ka qenë i ndarë në 4 vilajete, ai i Kosovës, i Shkodrës, Janinës dhe i Manastirit, secili vilajet ka pasur figura që janë shquar për veprimtarinë e tyre patriotike dhe arsimore. Atdhetarët e Shkodrës përdornin alfabetin e “Agimit”, sikurse ata të Kosovës. Toskët përdornin alfabetin latin dhe atë të Sami Frashërit (alfabetin e “Stambollit”). Ishte vështirësi për botuesit e librave, sepse ishte rëndë për t'u gjetur shtypshkronjë e cila i përmbante këto germa, përveç ajo e alfabetit latin, për të cilin ka pasur

shtypshkronja në tërë Evropën. Dallimi që ka ekzistuar ndërmjet alfabeve të ndryshme e bëri që të sillet vendim për krijimin e një alfabeti, një për të gjithë dhe i pranishëm nga të gjithë. Fjala vjen, kur erdhi momenti që të tre alfabetet të bashkohen në një, sepse, sipas planit të Kongresit, duhej që të formohej një alfabet, një kombinim nga ata që ekzistonin dhe alfabetet ekzistues të lihen mënjanë, kjo solli pra edhe mosmarrëveshjet ndërmjet përfaqësuesve ose themeluesve të alfabeve në fjalë, sepse secili e mbronte të vetin. Ka qenë tepër vështirë që të sillej vendim, i cili do t'ia plotësonte dëshirat të gjithëve. Edhe vetë themeluesit e alfabeve të ndryshëm nuk ishin me faj, që pa bashkëpunim, krijonin vepra individuale, sepse të rrihej dhe të pritej kaq kohë d.m.th. deri më 1908-ën ishte mëkat dhe dobësi e madhe për letërsinë shqipe, sepse, rrethanat ishin të tilla që ishte patjetër për të botuar libra dhe punime të ngjashme. Ishte medoemos, sepse gjuha nuk përparonte, shkolla nuk ecte përpara, punimet nuk do të kishin vlerën e tyre pa një alfabet të vetëm. Ky pra ishte hapi i parë drejt bashkimit etnik duke e parë nga njëri aspekt.

Nëse vazhdohej në këtë mënyrë dhe të mos ish

krijuar një alfabet i ri siç ishte ose siç është ky i Manastirit ose alfabeti i “Bashkimit”, a vallë sot ne shqiptarët do të ishim në këtë gjendje? Është realitet kur themi se alfabeti na bashkoi. (na bashkoi si komb e jo territorialisht) Në atë periudhë ishte rëndë dhe e palogjikshme që një njeri të mund të paramendonte se çfarë mund të ndodhte me botën shqiptare sot, ose mbas 100 vjetëve. Ose



kemi pasur fat që u soll vendim për përdorim të alfabetit latin, ose ata të cilët e përmbanin kishin pasur vizione të zhvilluara dhe burrërisht qëndruan prapa interesave mbarëkombëtarë. Me vetë themelimin e Alfabetit të Manastirit, shqiptarët treguan se janë popull i civilizuar, po i afrohen botës së qytetërimit, një alfabet i njësuar ishte fillimi i letërsisë mbarë shqiptare.

Duke lexuar mjaft vepra dhe fejtone lidhur me këtë temë, si nga autori Reshat Nexhipi, Tomor Osmani, etj., konstatova se meritat më të mëdha për bashkimin të tre alfabeve pa tjetër që i ka pasur dhe i ka klubi “Bashkimi”, por ai që e nxiti edhe më tepër punën del se është Gjergj Fishta. Kjo vërehet kur ai paraqitet në foltore dhe drejtohet para të gjithëve me fjalët: “S’kam ardhur që të mbroj asnjë alfabet, por, të mbroj një alfabet të përbashkët”. Me fjalët e tij, në punimet e këtij Kongresi, tregoi që nuk kish ardhur për të përçarë, por për të bashkuar. Dhe ai që e kuptoi dhe që e ndjeu vlerën të këtyre fjalëve s’ma merr mendja që s’e ka përmbajtur një alfabet të përbashkët. Nuk ishte gjë e rastit kur një nga të pranishmit, fjala vjen, kleriku mysliman Ibrahim Efendiu del në foltore dhe me lot në sy e përqafton Gjergj Fishtën duke e kuptuar rëndësinë të fjalëve të tij. Por, kishte të tillë që e mbronin të veten, dhe ishte e logjikshme që ta mbronin, sepse, ende nuk kuptonin se çfarë do të fitohej me alfabetin latin, ndërsa këta që ishin organizatorë, ose ideologëve që iu kujtua nuk mundnin të shpreheshin haptas për shkak të prezencës së mjaft “jabanxhinjeve”, siç ishte valiu i Manastirit, etj.. Rrymat sundonin rreptë duke i mbrojtur alfabetet vendase. Përpjekjet e atdhetarëve shqiptarë për të zgjidhur çështjen e një alfabeti të vetëm u dendësuan shumë. Por, në mënyrë direkte ose indirekte u pajtuan pothuajse të gjithë dhe fund i fundit, shqiptari kur është në pyetje interesi kombëtar nuk e kursen as veten. Shkurt, vendosmëria e delegatëve, synimi kah përfundimi i intelektualëve shqiptarë ishte aq i fuqishëm sa që si dilte përballë as propaganda greke, sllave dhe as ajo turke. Dhe në fund delegatët nuk u dëshpëruan, përkundrazi atë zgjidhje që i dha Kongresi i Manastirit, mësimin e alfabetit të shqipes, e konsideronin si një fitore të madhe që arriti që t’i bashkonte shqiptarët dhe kështu t’u japë një shtyllë të fuqishme gjuhës dhe shkollës. Bashkim i Gegërisë dhe Toskërisë.

Ka pasur edhe momente të rënies, këto ishin pra ato momente të rënies, diçka që e ke krijuar vetë, me sakrificë të mëdha, duke menduar se ajo

është e vërteta, duhet në një moment ta hedhësh ose ta lësh prapa në histori. Politika e armikut, e cila i përngjante tepër asaj “përça dhe sundo” u zhduk nga atdhetarët, të cilët, pa rezervë, dhanë kontribut për bashkimin e popullit. Pra, ka pasur me të vërtetë momente të rënda të papërshtatshme, dhe mos themi edhe njëherë se çfarë bën shqiptari kur është në pyetje interesi kombëtar.

Çfarë do të ndodhte me shqiptarët, nëse Kongresi mbaronte pa efekt? Çfarë mendimi do të kishte për ne bota sot nëse e përdornin alfabetin arab, ose Amerika dhe Evropa, të jem më i qartë? A vallë nuk e përforcojmë tezën për lashtësinë e gjuhës shqipe me përdorimin e alfabetit latin, tezë e cila është vërtetuar në institutin e gjuhëve në Zvicër, ku në mënyrë figurative në formë të një druri, gjuha shqipe e ka vendin ose e mban vendin e rrënjës? Dhe më në fund thjesht të them, a vallë do të ekzistonim si komb?

Kongresi i Manastirit nuk e përqendroi vëmendjen vetëm në problemin e zgjidhjes së alfabetit të gjuhës, por edhe në çështje të rëndësishme politike. U vendos që të shpallej si klub qendror klubi “Bashkimi” i Manastirit, ngase luajti një rol të rëndësishëm për shkrimin dhe shkollën shqipe, i shërbeu ngritjes së ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar dhe unitetit të tij.

Kongresi i Manastirit, me atë që e bëri, që krijoi një alfabet të ri, jo vetëm që u mundësoi shqiptarëve të kenë një alfabet të përbashkët, por një herë e përgjithmonë u krye problemi rreth shqiptarizmit anëmbanë botës.

Një komb, një gjuhë, një abece. Abece manastirase e cila ndriti historinë dhe ne gjeneratave të reja na e hoqi atë problem nga koka, rreth asaj çështjeje është kryer puna, na mbetet vetëm që ta kryejmë edhe një akt, për të cilën rilindësit tanë të bekuar, ose nuk patën kohë ose nuk mundën, sidoqoftë ne na mbeti, dhe nuk duhet theksuar, duke menduar se e dinë të gjithë se për çfarë bëhet fjalë, gjë që e mundon çdo shqiptar të Ballkanit dhe të diasporës.

Tani un prapë do ta ndërroj temën, ajo nuk është e ndërruar por do të shkoj disa vjet më pas, në Luftërat Botërore.

Paramendoni sikur të gjithë shqiptarët t’i bashkoheshin çetave të Xhem Hasës, ose Ballistëve trima, a vallë sot nuk do të kryhej problemi rreth asaj që duhet ta bëjmë?

“Një komb, një gjuhë, një flamur, një abece, një.....”. Të fundit, të pambaruarën, i lë lexuesit ta gjejnë.

Tonin ÇOBANI
Tiranë

PESE MUNDIMET E FISHTËS

(Pjesa e parë)

Poeti Kombëtar në shënjestrën e Salierëve të kohës së vet

Gjatë periudhës së sundimit ideologjik (realizmi socialist) Gjergj Fishta ka qenë i ekskomunikuar. Ky ndëshkim i ka ardhur pas vdekjes: autorit të “Lahutës së Malcis” duhej t’i zhbëhej emri dhe t’i shkulej e gjithë vepra nga trangu, prej të cilit kishte mbirë.

Por nuk do të ishim krejtësisht të saktë nëse do ta vështronim “Fishtën të ndëshkuar” vetëm *post mortem*. Qysh kur ishte student e, më pas, frat katundesh a në qytetin e Shkodrës, qysh kur ishte deputet i Parlamentit në Tiranë a përfaqësues i Shqipërisë në shtetet e rajonit e më gjerë, Poeti ka qenë në shënjestër të Salierëve të kohës së vet.

Dhe kjo i ka ndodhur, ndoshta, deri në ditët e fundit të jetës, kur në një mot të papërshtatshëm, ai ikte nga Shkodra për të mos u kthyer më kurrë.

Më poshtë do të veçoj pesë episode që goditën Fishtën gjatë jetës me qëllim neutralizimin e tij (dhe të veprës) prej lexuesve, më parë se të shpallej ekskomunikimi i tij institucional, i cili ndodhi menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore.

Studenti “i rebeluar”

Biografët e Gjergj Fishtës na bëjnë me dije se diçka ka ndodhur në kuvendin e Livnos (Bosnjë), ku françeskanët e rinj shqiptarë studionin teologji. Fishta ka formuluar një kërkesë (“letër-ankese” e quan një studiues), me anën e së cilës kërkohej që studentëve shqiptarë t’u njihej e drejta e organizimit në një shoqatë letrare-kulturore, të themi, etnike. Kjo shkresë u është dërguar eprorëve të kuvendit më 2 shtator 1892. I pari në listën e dhjetë firmëtarëve është fra Gjergj Fishta, i cili aso kohe mbante një emër tepër të gjatë: Enea-Silvio-Giorgio Fishta (Giorgius Silvius Enea Fiscta).

Më tej shkaqet e kësaj letër-ankese të pazakontë për kuvendet françeskane i gjurmon një studiues i ditëve të sotme, Nikë Ukgjini. Ai arrin në përfundimin se studentët shqiptarë kanë shpallur me këtë rast pakënaqësinë e tyre për çmeritimet që i bënin studentët e tjerë sllavë, duke krijuar *keqkuptime etnike, nënçmime, përbuzje, xhelozira, sharje, poshtërime dhe fyerje gjithfarëshe*.

Me raste, nuk përjashtohen reagimet. Madje Ukgjini, i cili për vete i ka kryer studimet e larta teologjike dhe ka doktoruar në një mjedis pak a shumë të përafërt me atë të Fishtës - ndonëse në kohë të ndryshme - aludon për një farë “rebelimi” të poetit të ardhshëm të Shqipërisë: fra Fishta edhe më parë kishte qenë ndëshkuar për reagime të ngjashme, që, për mikpritësit, konsideroheshin të papranueshme. Kështu, njëri prej etërve të





kuvendeve françeskane të Bosnjës, ku studionte Fishta, ka reaguar për dozën e “rebelimit” të studentit shqiptar, duke ia ulë notën në sjellje: e kishte “shkëlqyeshëm” si për të gjitha lëndët e tjera, i bëhet “mesatare” dhe, më pas, “mjaftueshëm”. Kjo kishte ndodhur qyshkur studionte filozofi në kuvendin e Kraljevo Sutjeskës gjatë viteve 1888-1889.

Pyetja që shtrohet sot është: ç’kuptim kanë dy nota më pak në sjellje për një frat që mbaron studimet e larta për t’iu dhënë gjatë gjithë jetës së vet përvujtërisë kristiane sipas shembullit të Shën Françeskut të Asizit? Dhe përgjigja nuk na vjen menjëherë, sepse na duket se, sido që të formulohet, do të tingëllojë jo natyrshëm. Mund të thuhet, megjithatë, se “rebelimi” i poetit të ardhshëm të shqiptarëve nuk ishte gjë tjetër veçse moskuptim i ndjeshmërisë së tij atdhetare e poetike: për gjëra të tilla ia vlejnë edhe disa nota më pak në sjellje.

“Ktheju nga ke ardhur!”


Me këtë titull kemi sjellë një episod tjetër, më pak të njohur deri sot. Ai ka ndodhur në vjeshtë të vitit 1906. Ne nuk e dimë me saktësi çfarë bëri e çfarë nuk bëri Fishta atë vit, por mësojmë se ai është shkarkuar nga detyra e drejtorit të shkollave françeskane të Shkodrës dhe është urdhëruar të kthehet nga kish ardhur, d.m.th., famullitar në fshatin Gomsiqe, që i perkiste Abacisë së Mirditës me qendër në Orosh.

Ky ndëshkim na bëhet i njohur përmes fratit tjetër, Pal Dodës, me të cilin poeti ynë ka pasur letërkëmbimin më të gjatë. Në një botim

përkujtimor të pas viteve '40 ai ka publikuar një letër të Fishtës të dërguar nga Gomsiqja më 26 nëntor 1906, duke sqaruar, se, për shkak të moskuptimeve dhe mërive, Fishtës “*iu desht... me u largue Shkodrës*”. Një e dhënë tjetër, që, atë “*iu desht... me u largue Shkodrës*” e lidh me kolegun dhe mikun e Fishtës, Shtjefën Gjeçovin, na ndihmon të sqarojmë kohëzgjatjen e kësaj lëvizjeje: nga vjeshta e vitit 1906 deri në maj të vitit 1907 Gjeçovin e gjejmë drejtor të shkollave françeskane të Shkodrës.

Kuptohet, pra, se gjatë kësaj kohe Fishta ka qenë i transferuar në famullinë e Gomsiqes. Pas largimit të Gjeçovit nga detyra e drejtorit të shkollave françeskane të Shkodrës, rikthehet Fishta.

Nuk është e vështirë të hetohen se mediokriteti i disa kolegëve dhe ligësia e snobëve





të qytetit të Shkodrës lidhen me faktin se Fishta futi në shkollat që drejtonte gjuhën shqipe si gjuhë mësimi, futi gjuhën shqipe në teatrin e shkollës dhe ishte një ndër më aktivët e Shoqërisë “Bashkimi” për alfabetin e njësuar të gjuhës shqipe, që do të vuloiset në Kongresin e Manastirit më 1908. Fakti që Fishta i kishte stigmatizuar Joho Begët e Palokë Cucët e Shkodrës në vargjet e veta satirike, të botuara asokohe në revistën e Konicës “Albania” (1905), gjithashtu, do të ishin të mjaftueshëm për të justifikuar qëndrime të tilla ndaj poetit. Por nuk na duken të mjaftueshëm.

Nga një ballafaqim me kryekonsullin e Austro-Hungarisë në Shkodër mësojmë se drejtori që kishte zëvendësuar Fishtën, pra Gjeçovi, nuk ka pranuar të urdhërohet prej mjekut austriak dhe ka lejuar festimin e 1 Maji nga mësuesit e nxënësit e shkollës së tij. Mos vallë për arsye të ngjashme të jetë dënuar edhe drejtori i mëparshëm? Ne nuk e dimë. Por nga letra që i dërgon Pal Dodës mësohet se Fishta flet për një shpifje të ultë që kishte qenë sajuar për të. Ai shpreson se do të sqarohet gjithçka në favor të tij. Dhe ashtu ndodhi: *“e vërteta ka triumfuar, ashtu siç ishte e natyrshme të triumfonte”*.

Në vitin 1907 Fishta u kthye përsëri në krye të shkollave françeskane. Dhe u kthye duarplot:

kishte botuar në Zarë “Lahutën e Malcis” (bleni i dytë), ka dalë nga shtypi në Sarajevë (ose pritët te dalë) vëllimi i satirave “Anzat e Parnasit” dhe në Shkodër broshura “Kombësia dhe kleri katolik”. Me t’u kthyer në detyrë, Fishta përfundon së ndërtuari “Sallonin teatror” të shkollës, që do të bëhet një portë e fuqishme komunikimi jo vetëm për nxënësit e shkollës dhe prindërit e tyre, por përgjithësisht për publikun shkodran, duke iu shtuar kështu edhe një “teatër” tjetër qytetit, që, në prag të shpalljes së Pavarësisë, e kishte rritur numrin e tyre sa zor se do ta arrijë më ndonjëherë. Kujtojmë se në këtë vit, pra më 1907, në Shkodër ka nisur të sillet nëpër rrugica biçikleta e parë: ishte një konsull nderi në Shkodër (i Suedisë) që solli dyrratëshin e parë në Shqipëri, të cilin më pas do ta pasojnë shkodranët, që edhe sot e kësaj dite e ruajnë traditën e biçikletave si asnjë qytet tjetër në Shqipëri e, ndoshta, në rajon.

Por çdo të thoshte për Fishtën ndeshtrasha që kaloi? Tërheqje vëmendjeje për të mos u marrë më gjatë me gjuhën shqipe? Një paralajmërim që të mos trajtojë më çështje kombëtare? Apo kërcënim për të mos prekur më hallet e vërteta të shkodranëve dhe të mbarë shqiptarëve? Le të mbetemi te sqarimi i Pal Dodës, që shkruan se kemi të bëjmë thjesht *“me mnijet e disave, të cilët nuk e kuptojshin”*.

Anton Nikë Berisha

Itali

PJETËR BUDI DHE TRADITA LETRARE (1566 – 1622)

Pjetër Budi (1566 – 1622) jetoi në një periudhë lëvizjesh të mëdha të botës së krishterë: reformës dhe kundërreformës. Në kohën kur ai i botoi tri veprat e përkthyer “Doktrina e krishterë” (1618), “Pasqyra e të rrëfyemit” (1621) dhe “Ritual i roman” (1621), poezitë, parathëniet dhe pasthëniet origjinale, kisha në Evropë kishte një ndikim të gjerë e të thellë në çdo aspekt të jetës së njeriut. Kjo ndodhi sidomos pas Koncilit të Trentos (1554 - 1563) kur ajo mori nën kontroll dhe në mbrojtje artet në përgjithësi, brenda tyre dhe artin e fjalës, letërsinë.

Pjetër Budi duhet të ketë pasur njohuri dhe të ketë lexuar autorë të shquar latinë dhe italianë, ose autorë, veprat e të cilëve ishin përkthyer në latinisht dhe në italisht, gjuhë të cilat i zotëronte mirëfilli. Ai do të ketë pasur njohuri edhe për letërsinë e barokut për arsye se në rrafshin tematik synimi i shkrimtarëve ishte të mohoheshin të mirat e botës tokësore dhe t'i jepej përparësi jetës – botës hyjnore (kundërvënie e synimeve të renesancës).

Mirëpo, duhet thënë se ajo që bën amëzën – qenësinë e poezisë së Budit, të parathëniet e të pasthëniet është Shkrimi i Shenjtë – Bibla, që jo vetëm në kohën e tij, po për shekuj me radhë, u lexua dhe pati një ndikim të shumëfishtë në filozofi, në antropologji, në sociologji, në muzikë, në pikturë etj., po dhe në artin e fjalës, letërsinë. Mjafton të përmenden këtu Psalmet, Këngën e këngëve, Himnet, Fjalët e urta, Librin e Jobit etj., që përligjin një rrafsh të lartë shprehës poetik, po dhe një shumësi tematike dhe qenësi mendimi, që pati ndikim të ndjeshëm në veprat letrare të periudhave të ndryshme. Brenda Biblës dhe literaturës biblike Budi u mbështet edhe në himne, në lavde dhe në lutje, që kishin një traditë të pasur duke filluar nga shekujt e parë të themelimit të krishterimit.

Natyrisht, për hartimin e poezisë së vet Budi



shfrytëzoi dhe traditën letrare gojore shqiptare, e cila edhe pse nuk ishte shënuar e botuar, bënte një jetë të gjallë në procesin e gojëshmërisë, duke u bartur prej një subjekti te tjetri.

Budi i hartoi poezitë e veta sipas një koncepti të caktuar: nis me Ditën e gjyqit, që lidhet me Ditën e gjykimit të veprimeve të individit të kryera gjatë jetës konkrete, për të vazhduar pastaj me historinë e lindjes së njeriut, me prindërit e parë (Adam dhe Evë), me lindjen e mëkatit, me shumimin e tij dhe me

ndërhyrjen e Hyjit – hedhjen në ferr të mëkatarëve dhe krijimin e një jete të re me Noan dhe fëmijët e tij që bëhen shembull i përfilljes së Fjalës së Hyjit, për të vazhduar me zënie e Jezu Krishtit në trupin e Marisë Virgjër, jetën e tij, pastaj kryqëzimin dhe ngjalljen pas tri ditësh, me çka zë fill një periudhë e re e jetës dhe e përsëritshmërisë së njeriut.

Budit i shtjelloi poezitë mbi bazën e një modeli të përbashkët. Nëse për një çast atyre u heqim titujt dhe i shënojmë me numra, ose i ndajmë me hapësira të vogla midis tyre, siç ngjet, fjala vjen, me ndarjen e strofave (për të kuptuar se është bërë një kapërcim, atëherë fitohet përshtypja se je duke lexuar një poemë të gjatë, të përbërë prej pjesësh, prej këngësh, që në rrafshin e sasisë, nuk është e domosdoshme të jenë të njëjta, siç ndodh me këngët e disa veprave të kësaj natyre të letërsisë sonë të shkruar, fjala vjen: “Te dheu i huaj” të Zef Skiroit, “Il Canzoniere albanese” të Françesk Anton Santorit, “Lahutën e Malcís” të Fishtës etj.. Po që se dikush, kushtimisht, do të thoshte se Budi e krijoi një lloj epi religjioz, që ka mbi 3000 vargje, atëherë mund të pohohet se kryepersonazhi i poemës është Hyji atë, Biri i tij, Jezu Krishti, Zoti konkret, i dukshëm dhe i prekshëm, Shpirti i Shenjtë (Trinia e Shenjtë), ndërsa Adami, Eva, Noa, Shën Maria, Shën Magdalena etj., janë degët e trungut që e plotësojnë atë, duke i dhënë tërësinë dhe

madhësitinë përkatëse.

Në poezinë e Budit, siç ndodh edhe në Bibël, Hyji është dashuri, është gjakim dashuror dhe ngushëllim shpirtëror. Hyji e krijoi jetën dhe i krijoi njerëzit si dëshmi e dashurisë ndaj tyre. I krijoi ata për të përjetuar jetën dhe që ata të jetojnë në harmoni e në mirësi me njëri – tjetrin. Në këtë mënyrë, Krijuesi (Hyji) njëjtësohet me të krijuarin (njeriun), ndërsa i krijuari (njeriu) për ta përligjur këtë njësim me Krijuesin, duhet ta përfillë e ta përligjë atë me veprimin dhe me jetën e vet të përditshme.

Shembull më i denjë i kësaj marrëdhënie, sa të veçantë aq dhe të denjë, në poezinë e Budit është Biri i Hyjit, Jezu Krishti, i dërguar nga Hyji midis njerëzve, shëmbëllim dhe konkretizim i vetë Hyjit atë: Ai u flijua në kryq, si dëshmi e dashurisë ndaj Atit të vet dhe ndaj njeriut, siç del dhe në poezinë e Budit: Se për ju jam dërguom, / Mbë këtë jetë me lëm, Për ju me u munduom / Gjithëve me u çpërblëm. Rëndësia e Krishtit përligjet nga fakti, siç thuhet në Ungjillin sipas Gjjonit, se te Hyji atë mbërrihet vetëm përmes Krishtit: “Askush nuk shkon tek Ati pos përmes meje” (Gjn 13, 6) për arsye se “Kush më ka parë mua (Krishtin – v. ime), ka parë edhe Atin... Unë jam në Atin e Ati është në mua” (Gjn 14, 9–10).

**Pjesë nga libri, Pjetër Budi poet dhe prozator.*



SHËN ROZA NGA LIMA VIRGJËR (1586 -1617)

Përgatiti, Dom Nosh Gjolaj

Më 23 gusht Kisha e përkujton Shën Rozën nga Lima. Siç ishte Shën Katrina e Sienes për Italinë, Shën Tereza e Avilës për Spanjën, ishte Shën Roza nga Lima për Perunë dhe për Amerikën Latine. Shën Roza lindi në Limë, në kryeqytetin e Perusë, më 20 prill 1586. Ajo ishte një nga shumë fëmijët e Gasper Flores dhe Maria de Oliva, me prejardhjen spanjolle. Sipas gjyshes ia japin emrin e pagëzimit Isabela, kurse kujdestarja apo shërbëtorja indianka fëmijën e quajti Roza, se ashtu e kishte fytyrën, ku më vonë tërë familja e përqafoi këtë emër. Po ashtu edhe ipeshkvi i Limës, Shën Turbi, e krezmoi me emrin Roza “trëndafil”, ku njihet në tërë botë me këtë emër. Në gjirin e familjes dha prova virtyti të lartë. Ajo donte që të bëhej murgeshë e Urdhrit Dominikan, por babai i saj e ndaloi atë. Në moshën 20 vjeçare ajo i mori rrobën e Urdhrit të Tretë të Shën Domenikut, bëri përparimet më të mëdha në rrugën e pendesës dhe të askezës mistike. Pas agjërimit të përditshëm, ajo vendosi të abstenojë përgjithmonë, të mos hante më mish. Shquhet për vepra bamirësie në shërbimin e nevojtarëve, të të sëmurëve, e të uriturve u bë një “trëndafil” i krishterimit në Amerikën e Jugut. Vdiq në moshën 31 vjeçare, më 24 gusht të vitit 1617. Për të lumtur e shpalli papa Klementi IX, më 10 maj 1667, kurse për shenjte e shpalli papa Klementi X, më 12 prill 1671, dhe ishte shenjtëresha e parë në Amerikë. Vendoset brenda kuvendit të Shën Domenikut në Limë së bashku me Shën Martinin de Porres dhe Shën Gjon Macias. Pas vdekjes Shën Roza bëri shumë mrekulli.

Kisha katolike e shpie festën e Shën Rozës në kalendarin liturgjik për tërë Kishën gjatë vitit 1729 dhe fillimisht është



festuar më 30 gusht, për shkak se më 24 gusht është festa e Shën Bartolomeut apostull. Pas reformës, në kalendarin liturgjik të vitit 1969, papa Pali VI e shpuri festën e Shën Rozës më 23 gusht, duke përjashtuar Perunë dhe disa vendet tjera të Amerikës Latine, ku e festojnë më 30 gusht.

“Kush përvujtërohet, do të lartësohet” (Mt. 23,12)

“Atë ditë mund të zgjidhja: t'i dedikohesha ndonjë pastrimi të prapambetur, në shtëpi, apo të nisja një punë më pak të lodhshme, por gjithsesi të dobishme... Zgjodha shërbimin e parë, për 't'iu vënë pranë të tjerëve, që atë ditë zhvillonin gjithashtu edhe një punë të lodhshme në kopsht. Disa ditë më pas jam kërkuar për këtë shërbim me më tepër pushim...' edhe për të tjerët kishte ardhur koha e çlodhjes. Ati sheh gjithçka!”





Ana Lalaj

DOSJET E LUFTËS

*Botimet Toena,
Tiranë, 2015*



FJALA HYJNORE

Prishtinë - Shkodër 2015



MIRA MEKSI

**MALLKIMI I PRIFTËRESHAVE
TË ILIRISË**

*Toena
Tiranë 2014*

KUMBONA E SË DIELËS
revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult
Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë

(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,

Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë

KUMBONA E SË DIELËS

Viti XXIX, nr. 5/6 (476-477) Maj - Qeshor 2015